



DRITA ISLAME

Botim i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë / Çmimi: 250 Lekë / www.dritaislame.al

Viti XXXV / Nr. 05 / MAJ 2026

Një jetë
me Të,
përjetë me Të صَلَّى اللهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ



“DRITA ISLAME”

Botim i Komunitetit Mysliman
të Shqipërisë

www.dritaislame.al

DREJTOR

Dorian Demetja

KRYEREDAKTOR

Mehmet Disha

DIZAJNI DHE FAQOSJA

Erzen Carja

KONTAKT:

Tel/fax +355 68 87 71 655

E-mail: mehmet.disha@kmsk.al

Viti XXXV i botimit

Nr. 05 (515)


Maj, 2026

ISSN 2226-7115

*Artikujt
që vijnë në redaksi
dhe botohen, nuk
paraqesin domosdoshmërisht
edhe pikëpamjet e revistës.*



www.dritaislame.al





editorial

04 Një jetë me Të, përjetë me Të
Mehmet Disha

në fokus

06 Familja, strehë e qetësisë dhe mëshirës
Tauland Bica

lajme / aktivitete

08 **01-Zhvillohet programi artistik “Profeti Muhamed (a.s), krenaria e njerëzimit”**
02-Kryetari i KMSH-së pret drejtues të institucioneve islame shqiptare në diasporë
03-Kryesia e KMSH-së zhvillon një mbledhje pune me Myftininë Tiranë
04-Promovohet botimi më i ri i institucionit, me titull “Zëri që vjen nga minberi”
05-Zhvillohet mbledhja e parë e Këshillit të Përgjithshëm për vitin 2026

refleksione

14 Ndjenja e vetëllogarisë / Abdullah Bulku

çështje fetare

16 Cilat janë kriteret për të dalë imam në namaz? Dhe si është radha? / Këshilli për Çështjet Fetare - insi.al

familja

18 Foleja më e rëndësishme e shoqërisë është familja
Dorian Demetja

horizonti i besimit

20 Sëmundja e vetëpëlqimit
Edison Hoti

22 Gruaja, zemra e familjes dhe shoqërisë
Jonida Cikalleshi

24 Puna dhe prona në optikën e fesë Islame
Rejan Dervishi

26 Sfida e integritimit kulturor të myslimanëve në botën perëndimore / Xhema Balla

28 Domosdoshmëria e fesë në shoqërinë moderne / Arel Senja

bota shpirtërore

32 Mrekullia e namazit
Saimir Bulku

hapësirë feminare

34 Këshilla 2
Redaksia

këndi i poezisë

38 Zgjohu
Mehmet Akif Ersoj



Një jetë me Të, përjetë me Të

“Asnjë burrë tjetër atij s’i afrohet,
Lum kush pati fatin me të të takohet.
Brumin e tij të bukur vetë lindja e tregoi,
T’bukur e pat fillimin e ashtu bukur e mbaroi...”
Busajriu

Vërtetë i Dërguari i Allahut, Muhamedi a.s. është shprehur se “Njeriu është me atë që do¹”. Kështu, mjeshtri i vërtetë i retorikës dha një fjalë sa shpresëdhënëse po aq edhe reale, një sekret për të qetësuar zemrën e një sahabi (shoku) që kish shqetësime që i vinin si rrjedhojë e dashurisë dhe frikës që zemra e mbushur me dashuri ka nga largësia, qoftë edhe nëse kjo largësi është thjesht një mundësi, një probabilitet i vogël; si dhe për të qetësuar zemrat e të gjithë atyre që do të vinin më pas, të cilët, të ngërthyer në largësitë e distancave kohë-hapësirë, do të kërkonin ‘të tjera shtigje’ përmallimi. Hadithi i mësipërm, në spektrin e **marifetit** na zbërthen disa sekrete që vetëm fjalët e një profeti mund të ngërthejnë, si njohës i të vërtetës që ish, si udhërrëfyes i atyre shtigjeve që ia mësoi Zoti e që ai më pas i përcolli si përgëzim për zemrat që kërkojnë me ngashërim po të njëjtat shtigje horizontesh të nalta.

Preokupimi real i zemrës dikton në njëfarë mënyrë, me lejen e Zotit, kohën dhe hapësirën me të gjitha dimensionet e dukshme e të fshehta që qenia ka në vetvete e përreth. E madje, kur kjo gjë kërkohet me vazhdimësi e përujje, apo thënë me gjuhën e të qenit rob i Zotit: kur kjo gjë lipset prej zemre, me ngulm, me përgjërime e vajë duke u mbështetur e duke qëndruar ashtu me **ubudijet**, me dimensionin e këndshëm të adhurimit, një rob që është pjekur nga pritja dhe që ka vërtetuar besnikërinë e fjalës dhe i ka dhënë hakun besës së dhënë, atëherë Allahu i mëson nëpërmjet gjuhës së dashurisë shtigjet e afërsisë dhe të bashkimit. Mund edhe të thuhej që njeriu është me atë që mendon, me atë që fiksohet, me atë që krijon lidhje a me atë

1. Buhariu, Edeb 96; Muslimi, Birr 161,163.

që rrin, ama këtu bëhet fjalë për “**mehabbeh**”, për dashurinë si një nga veprimtaritë e zemrës e që nuk e merr përsipër mendja e arsyeja.

Rruga që shkon për tek Zoti kalon nga Profeti Muhamed a.s., dhe porta e dashurisë siç shprehet edhe në ajetin e sures Ali Imran, çelet vetëm pasi njeriu të jetë edukuar, pastruar, rrokullisur e dëlirësuar nëpërmjet sheriatit që Allahu i dha Profetit, pra sistemit të rregullave fetare që diktojnë fizikun e robit dhe ia nënshtrajnë atë metafizikës së tij; pra thënë ndryshe: Pasi nefsi të jetë edukuar, pastruar e nënshtruar dhe njeriu që kërkon shtigjet e përjetësisë, zgjerohet në dimensionet e jetës së zemrës e shpirtit: **“Thuaj (o Muhamed) nëse e doni Allahun, atëherë ndiqmëni mua që t’ju dojë Allahu, e t’ju falë mëkatet, se vërtetë që Allahu është që fal shumë, mëshiron shumë!”**

Ja rruga, ja mejdani! Është pikërisht ky spektri i jashtëzakonshëm i një nga një mijë e më shumë dritareve që ka ajeti; **“E nuk të dërguam ty (ja Muhamed) vetëm së mëshirë për gjithë botët!”**³ Kjo mirësi e madhe që Allahu solli me të dërguarin e Tij, me një sistem vlerash e moralesh të paçmueshme që e ndërgjegjësojnë robin drejt kërkesave reale të zemrës, që e ngrenë dhe e lartësojnë drejt shtigjeve të amshimit.

Muhamedi a.s. nuk ishte vetëm një i dërguar, si shumë të dërguar të tjerë para tij. Ai ishte profeti me të cilin Zoti i dha fund zinxhirit të profetëve. Ai ishte një njeri me të cilin Zoti nderoi dhe gradoi njerëzimin. Nëse drejtësia do të mishërohej dhe merrte formë, ajo do të merrte formën dhe pamjen e Muhamedit a.s. Nëse dëlirësia e shpirtit do të pikasej diku, padyshim do të pikasej në shpirtin e tij. Nëse virtyti do të pikturohej, nuk do të kishte tablo më optimale sesa ajo e Muhamedit a.s. Po ai ishte njeri, lëvizte në tregje dhe ushqehet si të gjithë njerëzit. Ajo që e dallonte nga të tjerët, ishte pikërisht nuri i profetësisë me të cilin rrezatonte.

2. Kuran, Surja Ali Imran, 3:31.

3. Kur’an, Surja Enbija, 21:107.

Pishtari i mesazhit hyjnor i ndriçonte udhën atij dhe atyre që i besonin. Fjalët e tij ishin të vërteta, veprat të drejta, udha e sigurt. Mëshira ishte bashkë me të kudo që të ishte. Bujaria kishte bujtinë shpirtin e tij. Ai i besonte lehtësimin, feja që përçoi ishte e lehtë, Kurani që iu shpall ishte i lehtë, tradita e tij ishte e lehtë, urdhrat dhe ndalesat të lehta. Teksa lexon biografinë e kolosëve të njerëzimit përkrah biografisë së Muhamedit a.s., të gjithë të duken të vegjël përballë tij. Kur lexon lajmet e reformatorëve përkrah lajmeve dhe jetës së tij, të gjithë shndërrohen në nxënës të Muhamedit a.s. Nëse mahnitesh me gjenitë, sapo lexon traditën profetike, të gjithë të tjerët i sheh si studentë të universitetit të Muhamedit a.s. Atë e kanë lavdëruar armiqtë përpara miqve dhe i largëti para të afërta.

“Se ti (o Muhamed) je me virtyte madhore.”⁴

Profeti Muhamed a.s. robëroi zemrat e njerëzve me dhembshurinë e vet, bashkoi të përçarët me dashurinë e tij, vëllazëroi fiset me urtësinë e tij, luftoi injorancën me dije dhe kështu me lehtësi hoqi qafe vargonjtë e traditave dhe zakoneve të vjetra. Ai u dërgua me fenë e lehtësimin, me besimin e dëlirë, me natyrën e pastër, me rrugën e mesme. Ai përçoi fenë dhe ndërtoi shtetin, falej si imam dhe predikonte fenë e tij. Secili nga shokët e tij rrefen dashurinë për Profetin a.s. sipas mënyrës së vet. Kushdo që ka biseduar me të, përshkruan ndjenjat dhe emocionet të shoqëruara me lot malli. Kushdo që e ka takuar, ka dëshmuar madhësitinë e tij, pavarësisht nëse është pajtuar me të apo jo. Askush nuk mban mend ndonjë shkarje të Profetit a.s., askush nuk i ka regjistruar ndonjë gënjeshtër dhe askush nuk njih ndonjë lapsus apo gabim të tij. Zoti ia ruajti zemrën të dëlirë, ia pastroi shpirtin, ia ruajti shikimin dhe dëgjimin. Vetë Zoti i Lartësuar e zgjodhi atë si të Dërguar për mbarë botët, mësues për të paditurit, model dhe shembull për njerëzimin. Sa më shumë lexon mbi jetën dhe biografinë e tij, aq më shumë të shtohet respekti, vlerësimi dhe nderimi për të. Prandaj ai u shndërrua në njeriun më të preferuar dhe më të dashur për të gjithë.

Ai jetoi mes shokëve të tij dhe prej tyre nxori prijës të drejtë, dijetarë të lidhur me Zotin, interpretues të Kuranit, predikues oratorë, asketë të devotshëm dhe komandantë legjendarë. Secili nga pasuesit mori një aspekt nga jeta e Profetit a.s., prandaj ata u shndërruan në kolosë të historisë dhe uje të botës.

Shembull ideal dhe mëshirë për njerëzimin

Në fytyrën e tij gjithmonë shihej një buzëqeshje, në ballin e tij dallohej një dritë, nga zemra e tij buronte dashuria dhe nga dora e tij rridhte bujaria. Me pak fjalë, ai ishte i bekuar në çdo mënyrë të mundshme. Edhe atëherë kur shpata i qëndronte mbi kokë në formë kërcënimi, ai nuk gënjente.

Edhe atëherë kur e joshnin me premtime për thesaret

e botës, ai prapë nuk i shkeli premtimet e tij, sepse ishte i zgjedhuri i Zotit, i mbrojtur prej Tij. Ai u dërgua si shembulli ideal dhe mëshirë për gjithë njerëzimin, falës për të tjerët, i cili ua fal shkeljet dhe ua fsheh dobësitë, i cili është i përmbajtur ndaj njerëzve injorantë dhe i mëshirshëm ndaj të varfërve e të dobëtëve.

Dinjiteti i tij arrinte ato grada sa frymëzonte tek të tjerët nderim, dashuri dhe admirim.

Në portretin profetik kishte një përputhje të plotë dhe harmoni mes pamjes fizike dhe botës shpirtërore. Ishin pikërisht virtytet shpirtërore të Profetit a.s. që e renditën dhe e bënë atë më të madhin personalitet të njerëzimit.

Në kurmin e tij të pastër bashkoheshin e bëheshin njësh: vitaliteti, bujaria, ndjeshmëria e drejtësia.

Do të jenë me të në Parajsë

Theubani r.a. e donte jashtë mase Profetin a.s. dhe nuk mund ta duronte ndarjen prej tij. Një ditë kur iu afrua, fytyrën e kishte shumë të zbehtë dhe dukej shumë i trishtuar. Profeti a.s. e pyeti se si qëndronte puna dhe ai iu përgjigj: “O i dërguari i Allahut, unë nuk kam dhimbje dhe nuk jam i sëmurë, por sa herë që jam larg teje, ndihem tepër i mjeruar derisa arrij të të shoh. Për më tepër, kur kujtoj botën tjetër, unë frikësohem për shkak se ju do të ngjiteni në “Ilijin” pallate madhështore me profetët. Nëse unë hyj në parajsë, do të jem në një nivel më të ulët se ju. Gjithashtu, nëse nuk hyj në parajsë, nuk do të kem kurrë mundësinë të të shoh.” Më pas u shpall ajeti vijues:

“Kushdo që i bindet Allahut dhe të Dërguarit, do të jetë me ata të cilët Allahu u ka dhënë shumë dhunti: me profetët, me të sinqertët, me dëshmorët dhe me të drejtët! Eh sa shokë të mrekullueshëm janë këta!”⁵

Ai është Profeti i të gjithëve

“O njerëz! Zoti juaj është një. Keni një origjinë. Të gjithë jeni bijtë e Ademit a.s. e Ademi është prej balte. Arabi nuk ka epërsi mbi jo-arabin, sikurse jo-arabi mbi arabin; as i bardhi mbi të ziun e as i ziu mbi të bardhin. Vlera e lartë është vetëm në takva (devotshmëri), t’i frikësohesh Allahut.”

Kjo ishte thirrja e Profetit të Islamit a.s. teksa largohej nga kjo botë. Vetëm për umetin u mundua, e para se të nisej pyeti: “A e kreve detyrën?”, ku si përgjigje i kthehet një jehonë e thellë e përbotur nga sahabët (shokët): “Po, ja Resulallah!” Pas kësaj, me një qetësi të begatë thotë: “Dëshmo, o Zoti im!”, drejtuar pafundësive.

Ai ishte Profeti i të gjithëve. Ishte përherë në përpjekje për shpëtimin e bijve të Ademit. Po edhe umeti nuk e harroi kurrë. Sa herë që kujtohet ai, zemra e besimtarit dridhet ëmbël me ngazëllim prej butësisë së begatë të qenies së tij.

4. Kuran, surja Kalem, 68:4.

5. Kuran, Nisa, 4:69.

FAMILIJA

strehë e qetësisë dhe mëshirës

Falënderimi i takon Allahut, Zotit të botëve, i Cili e krijoi njeriun në formën më të bukur, e nderoi me besim dhe e bëri familjen strehë të qetësisë, dashurisë dhe mëshirës. Paqja, mëshira dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të Dërguarin tonë Muhamedin ﷺ, mbi familjen e tij të pastër, mbi shokët e tij fisnikë dhe mbi të gjithë ata që ecin në gjurmët e tij deri në Ditën e Gjykimit.

Prej mirësive që Allahu i Madhëruar i ka dhuruar njeriut në këtë botë është edhe familja. Ajo është vendi ku zemra gjen qetësi, ku shpirti pushon nga lodhjet e jetës dhe ku njeriu mëson dashurinë, sakrificën dhe përgjegjësinë. Allahu i Madhëruar thotë në Librin e Tij Fisnik:

(وَمِنْ آيَاتِهِ أَنْ خَلَقَ لَكُمْ مِنْ أَنْفُسِكُمْ أَزْوَاجًا لِتَسْكُنُوا إِلَيْهَا وَجَعَلَ بَيْنَكُمْ مَوَدَّةً وَرَحْمَةً)

“Dhe prej shenjave të Tij është që për ju krijoi bashkëshorte nga vetë lloji juaj, që të gjeni qetësi tek ato, dhe vendosi ndërmjet jush dashuri dhe mëshirë.”
(Er-Rum, 21)

Ky ajet na mëson se themeli i familjes në Islam nuk është vetëm bashkëjetesa materiale, por qetësia shpirtërore, dashuria dhe mëshira reciproke. Familja në Islam nuk është thjesht një institucion shoqëror, ajo është amanet hyjnor dhe themeli mbi të cilin ndërtohet shoqëria. Prandaj Islami i kushtoi familjes një rëndësi të jashtëzakonshme.

Që nga krijimi i njeriut të parë, Allahu i Madhëruar e vendosi familjen si mënyrën e natyrshme të jetës njerëzore. Ademi dhe Havaja ishin familja e parë mbi tokë, duke na treguar se jeta njerëzore fillon me familjen dhe ruhet përmes saj. Për këtë arsye, Islami e nxit martesën dhe e konsideroi atë pjesë të traditës profetike.

I Dërguari i Allahut ﷺ ka thënë: “Martesa është prej sunetit (traditës) tim, e kush largohet nga suneti im nuk është prej meje.” Kështu, në një kohë kur shumë vlera po tronditen dhe kur familja po përballet me sfida të shumta morale e shpirtërore, besimtari duhet ta konsiderojë ruajtjen e vlerave familjare si ruajtjen e vetë moralit të fesë.

Kur flasim për familjen në Islam, shembulli më i përsosur është vetë i Dërguari i Allahut ﷺ. Ai ishte

pejgamber, udhëheqës, gjykatës dhe njeriu më i dashur tek Allahu, por megjithatë gjente kohë për familjen e tij, i ndihmonte, i dëgjonte dhe sillej me butësi ndaj tyre.

Transmetohet se Aishja (r.a) kur u pyet: “Çfarë bënte Profeti ﷺ në shtëpinë e tij?”

Ajo u përgjigj: “Ai ishte në shërbim të familjes së tij; qepte rrobat e veta, ndreqte sandalet dhe ndihmonte në punët e shtëpisë.”

Ja pra, ky ishte Profeti Muhamed (a.s). Ai që drejtonte umetin, nuk e konsideronte ulje të dinjitetit të ndihmonte familjen e tij. Ndërsa sot, disa njerëz mendojnë se burrëria qëndron në ashpërsi, në urdhra dhe në largësi emocionale nga familja.

Ai na mësoi se madhështia e burrit nuk matet me forcën ndaj familjes, por me butësinë dhe mëshirën ndaj saj. Prandaj ai e përmbodhi moralin familjar në një fjali madhështore kur tha: “Më i miri prej jush është ai që është më i miri me familjen e tij.”

Kemi edhe rastin e vajzës së Profetit a.s, Fatimes (r.a) Ajo jetonte me thjeshtësi dhe vështirësi, por shtëpia e saj ishte e mbushur me bereqet dhe iman. Një ditë ajo shkoi tek babai i saj për të kërkuar një ndihmëse, për shkak të lodhjes nga punët e shtëpisë. Por, ai në vend të ndihmësës, i mësoi asaj që para gjumit të thoshte 33 herë “Subhanallah”, 33 herë Elhamdulillah, dhe 34 herë Allahu Ekber, dhe se kjo do të ishte më e mirë për vetë atë.

Kjo ngjarje na mëson se familja besimtare nuk ndërtohet vetëm me rehati materiale, por me lidhje të fortë me Allahun. Sot shumë familje kanë komoditet, por u mungon qetësia. Kanë teknologji, por u mungon komunikimi. Kanë luks, por u mungon bereqeti. Familja myslimane ndërtohet mbi devotshmëri, respekt dhe përgjegjësi. Burri dhe gruaja nuk janë rivalë, por plotësues të njëri-tjetrit.

Allahu i Madhëruar thotë: **“أَتَىٰ هُنَّ لِبَاسٍ لَكُمْ وَأَنْتُمْ لِبَاسٍ لَهُنَّ”** **“Ato janë petk për ju dhe ju jeni petk për ato.”** Petku mbulon dhe zbukuron. Kështu duhet të jetë edhe marrëdhënia bashkëshortore, mbrojtje nga gabimet, mbështetje në vështirësi dhe zbukurim i jetës së njëri-tjetrit.

Prandaj mirësia e njeriut nuk matet vetëm me namazin dhe fjalët e bukura në publik, por me sjelljen e tij brenda

shtëpisë. Sa njerëz tregohen të buzëqeshur me të huajt, por të ashpër me familjarët! Sa njerëz kërkojnë respekt nga fëmijët, ndërsa nuk u japin atyre dashuri dhe shembull të mirë!

Një prej shtyllave më të rëndësishme të familjes është edhe edukimi i brezit të ri. Fëmijët janë amanet i Allahut në duart tona. Ata nuk kanë nevojë vetëm për ushqim dhe veshmbathje, por mbi të gjitha për edukatë, moral dhe shembull të mirë.

Allahu i Madhëruar thotë: **يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا قُوا أَنفُسَكُمْ وَأَهْلِيكُمْ نَارًا** "O ju që besuat! Ruajeni veten dhe familjet tuaja nga zjarri." (Et-Tahrim, 6) Pra, ruajtja e familjes nga zjarri bëhet duke i edukuar me besim, duke i mësuar namazin, moralin, respektin dhe frikën ndaj Allahut.

Profeti ﷺ ka thënë: "Të gjithë jeni barinj dhe të gjithë do të pyeteni për kopenë tuaj." Prindi do të pyetet për fëmijët e tij. Burri do të pyetet për familjen e tij. Gruaja do të pyetet për amanetin e shtëpisë së saj.

Në një hadith tjetër Profeti ka thënë: "Trashëgimia më e bukur që një baba mund t'i lërë fëmijës së tij është edukata e mirë." (Tirmidhi, Birr 33) Shumë fëmijë sot nuk kanë nevojë vetëm për ushqim dhe veshmbathje, por kanë nevojë për prindër që i dëgjojnë, që u flasin dhe që u japin kohë.

Profeti (a.s.), edhe pse mbante barrën e shpalljes, i përqafonte fëmijët. Një herë, kur ai po puthte nipërit e tij Hasanin dhe Husejnin, një beduin i tha: "Unë kam dhjetë fëmijë dhe nuk kam puthur asnjërin prej tyre." Ndërsa Profeti (a.s.) iu përgjigj: "Kush nuk mëshiron, nuk mëshirohet." Ky hadith është mesazh për çdo prind. Fëmijët nuk rriten vetëm me disiplinë, por me dashuri dhe mëshirë.

Po ashtu, Islami na mëson respektin ndaj prindërve. Një herë Abdullah ibn Mesudi (r.a) pyeti Profetin (a.s) se "Cila është vepra më e dashur tek Allahu?" Ai tha: "Namazi në kohën e tij." Po pas namazit? e pyeti përsëri. Këtë herë ai tha: "Mirësia ndaj prindërve." Sot, në një kohë kur shumë prindër ndihen të vetmuar, Islami na kujton se respekti ndaj tyre është rrugë drejt kënaqësisë së Allahut.

Nga ana tjetër, prej sprovave më të mëdha të kohës sonë është se shoqëria po përjeton një krizë të thellë familjare. Shtëpitë janë mbushur me mjete komunikimi, por zemrat janë zbratur nga komunikimi i vërtetë. Familjet jetojnë nën të njëjtën çati, por larg njëri-tjetrit në shpirt dhe në ndjenja. Shpesh babai është i zënë me telefonin e tij, nëna me lodhjet e saj, fëmijët me ekranet e tyre. Në shumë shtëpi mungon biseda, mungon dëgjimi, mungon përqafimi dhe fjala e mirë. Dashuria po zëvendësohet nga egoizmi, respekti nga ashpërsia dhe sakrifica nga individualizmi. E gjithë kjo ndodh atëherë kur familja largohet nga udhëzimi hyjnor.

Familja nuk mbahet me përsosmëri, sepse askush nuk është i përsosur. Ajo mbahet me durim, falje dhe sakrificë. Çdo familje ka sprovat e saj, por familja

besimtare nuk dorëzohet lehtë. Ajo e ndërton jetën mbi iman, mbi komunikim dhe mbi mëshirë.

Prandaj le ta pyesim veten:

Sa kohë i kushtojmë familjes sonë?

Sa herë u themi prindërve "Allahu jua shpërbleftë"?

Sa herë përqafojmë fëmijët tanë?

Sa herë kërkojmë falje nga bashkëshorti apo bashkëshortja?

Mos e lini dashurinë për nesër.

Mos e vononi faljen.

Mos kurseni fjalën e mirë.

Sepse mund të vijë një ditë kur do të kemi kohë, por nuk do të kemi më mundësinë për t'i thënë ato fjalë që zemra i mbajti gjatë në heshtje.

E lusim Allahun e Madhëruar që t'i mbushë familjet tona me iman, dashuri dhe mëshirë. Të na bëjë prej atyre që ndjekin shembullin e Profetit Muhamed (a.s.) në jetën fetare e familjare. Të na bëjë prindër të mirë, fëmijë të devotshëm dhe bashkëshortë që ndihmojnë njëri-tjetrin.

Allahu e largoftë urrejtjen, padrejtësinë dhe përçarjen nga shtëpitë tona, si dhe na bashkoftë në mirësi, në këtë botë dhe në botën tjetër. Amin



01 ZHVILLOHET PROGRAMI ARTISTIK “PROFETI MUHAMED (A.S), KRENARIA E NJERËZIMIT”



Diten e sotme, në ambientet e Akademisë së Arteve u zhvillua një program artistik kushtuar Profetit Muhamed (a.s) me temë “Profeti Muhamed (a.s), Krenaria e Njerëzimit”

Në kuadër të kësaj mbrëmjeje, u ndanë edhe çmimet për fituesit e edicionit të pestë të konkursit ndërkombëtar “Urtësitë e Traditës Profetike”, konkurs ky i cili u zhvillua më herët në ambientet e Kolegjit Universitar “Bedër”.

Mbrëmja u çel me leximin e disa ajeteve Kuranore nga hafizi Enes Hyka, për të vijuar më tej me fjalën përshëndetëse të Kryetarit të Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, h. Bujar Spahiu, i cili vlerësoi pjesëmarrjen aktive të të rinjve dhe theksoi rëndësinë e mesazheve profetike në kohët moderne, duke u shprehur se mësimet e Profetit (a.s) mbeten një udhërrëfyes i përhershëm për ndërtimin e një shoqërie me vlera, drejtësi dhe harmoni për të gjithë ne.

Të pranishmit i përshëndeti gjithashtu edhe Prefekti i Qarkut Tiranë, z. Shkëlqim Hajdari, i cili ndau vlerësimin e tij për këtë organizim dhe u drejtua të rinjve me mesazhe inkurajuese.

Më tej, z. Jamal Alsaferti, përgjegjës i Departamentit të Shkencave Islame në Kolegjin Universitar “Bedër”, nënvizoi rëndësinë e iniciativave të tilla në thellimin e njohjes së jetës dhe trashëgimisë profetike, si dhe në përkthimin e këtyre mësimëve në praktikë të përditshme.





Programi vijoi më tej me poezi, ilahi dhe interpretime të ndryshme të realizuara nga studentët e Departamentit të Shkencave Islame në "Bedër" dhe nxënësit e Medresesë së Tiranës. Një vlerë e shtuar e mbrëmjes ishin edhe interpretimet e aktorit Dritan Boriçi dhe këngëtarit Erlind Zeraliu.

Pas këtij programi artistik, u zhvillua ceremonia e ndarjes së çmimeve për tre kategoritë e konkursit. Çmimet u ndanë nga Nënkryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, z. Taulant Bica, Rektori i Kolegjit Universitar "Bedër", Prof. Dr. Gjergji Sinani, si dhe Drejtori i Medresesë së Tiranës, z. Ardit Dragoti.

Komuniteti Mysliman i Shqipërisë përgëzon të gjithë fituesit dhe pjesëmarrësit, duke shprehur mirënjohje për kontributin e të gjithë atyre që bënë të mundur realizimin e këtij aktiviteti, i cili çdo vit nxit qindra të rinj të hulumtojnë dhe reflektojnë mbi jetën dhe veprën e Profetit Muhamed (a.s).



02 KRYETARI I KMSH-SË PRET DREJTUES TË INSTITUCIONEVE ISLAME SHQIPTARE NË DIASPORË



Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Bujar Spahiu, priti në një takim drejtues të rëndësishëm të institucioneve islame shqiptare në diasporë.

Në takim ishin të pranishëm Kryetari i Komunitetit Mysliman Shqiptar në Zvicër (KMSHZ), H. Mehas Alija; Kryetari i Unionit të Bashkësive Islame Shqiptare në Gjermani, z. Mensur Halili; si dhe Drejtori për Diasporë në Bashkësinë Fetare Islame në Maqedoninë e Veriut, z. Mafiz Rustemi, të cilët shoqëroheshin nga imamë dhe anëtarë të komuniteteve të tyre respektive.

Gjatë bisedës u diskutua mbi zgjerimin e bashkëpunimit ndërinstitucional, me fokus në shërbimin ndaj besimtarëve shqiptarë në diasporë, shkëmbimin e përvojave dhe zhvillimin e projekteve të përbashkëta në fusha fetare, arsimore dhe sociale.

Në fjalën e tij, Kryetari i KMSH-së vlerësoi punën dhe përkushtimin e institucioneve islame shqiptare në diasporë, duke theksuar rolin e tyre të pazëvendësueshëm në ruajtjen e identitetit. Ai u shpreh se shqiptarët në mërgatë kanë arritur të ruajnë gjuhën, të përkujtojnë vazhdimisht atdheun dhe të kultivojnë vlerat më të mira shpirtërore, duke dëshmuar se feja dhe kombi nuk janë dy shtylla që përplasen, por dy drita që ndriçojnë njëra-tjetrën.

Të pranishmit vlerësuan rëndësinë e forcimit të lidhjeve ndërmjet institucioneve dhe rolin e diasporës në ruajtjen e identitetit fetar dhe kombëtar. Ky takim u zhvillua në kuadër të pjesëmarrjes së delegacioneve në Samitin e katërt të Diasporës shqiptare me temë "Përmes rënjëve lartësohemi", i cili organizohet nga qeveria shqiptare



03 KRYESIA E KMSH-SË ZHVILLON NJË MBLEDHJE PUNE ME MYFTININË TIRANË



Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Bujar Spahiu, së bashku me anëtarë të tjerë të kryesisë, zhvilloi një takim pune me Myftininë e Tiranës, ku u prit nga Myftiu, z. Gazment Teqja, administratori dhe imamët myftinisë.

Kjo mbrëmje nisi me leximin e disa ajeteve Kuranore nga hafizi Eduart Shtrezi, për të vijuar me fjalën hapëse të Myftiut Teqja, i cili u uroi mirëseardhjen të pranishmëve dhe i njohu ata shkurtimisht me rendin e kësaj mbledhjeje.

Më tej, fjalën e mori Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Bujar Spahiu, i cili theksoi nevojën për forcimin dhe rigjallërimin e institucioneve themelore fetare, duke u ndalur veçanërisht të rëndësia e zekatit dhe sadakasë së fitrit, si dhe të konsolidimi i procesit të anëtarësimeve. Ai vlerësoi gjithashtu rolin e kurseve fetare në edukimin e brezave të rinj dhe nënvizoi përgjegjësinë për një përcjellje të qartë, të matur dhe bashkëkohore të mesazhit islam.

Ndërsa Nënkrjetari i Institucionit, z. Lauren Luli, u ndal në mbarëvajtjen e aktiviteteve fetare në xhami, si dhe organizimin e haxhit dhe umres, duke bërë thirrje për bashkëpunim më të thellë në këto aspekte.

Kjo mbrëmje vijoi më tej me fjalën e Drejtorit të Financës në KMSH, z. Edison Hoti, i cili u fokusua në diversifikimin e burimeve financiare dhe ndërtimin e një kalendari pune për fushatat sensibilizuese, me synim rritjen e ndërgjegjësimit dhe përfshirjes komunitare.

Mbledhja vijoi më tej në formën e një diskutimi të hapur me imamët mbi aspekte të ndryshme të punës së tyre të përditshme.



04 PROMOVHET BOTIMI MË I RI I INSTITUCIONIT, ME TITULL “ZËRI QË VJEN NGA MINBERI”



Komuniteti Mysliman i Shqipërisë zhvilloi në ambientet e Tirana International Hotel një aktivitet promovues me rastin e botimit më të ri të institucionit, me titull “Zëri që vjen nga minberi”. Ky botim vjen si një databazë e imamëve që kanë shërbyer nga rihapja e besimit në vendin tonë në vitet ‘90 e deri në dhjetor të vitit 2025.

Në këtë aktivitet morën pjesë figura të rëndësishme të institucionit, mes tyre Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Bujar Spahiu, Kryetari i Këshillit të Përgjithshëm, z. Islam Hoxha, nënkryetarët, anëtarë të kryesisë, myftinj, imamë si dhe përfaqësues të shoqatave të ndryshme.

Në fjalën e tij përshëndetëse, kryetari Spahiu falënderoi të pranishmit për pjesëmarrjen dhe e vlerësoi këtë botim si një kontribut të çmuar në evidentimin dhe vlerësimin e figurës së imametit ndër vite. Në vijim, Kryetari i Këshillit të Përgjithshëm të institucionit, z. Islam Hoxha, theksoi përgjegjësinë e lartë që mbart imami si amanet hyjnor, duke u mbështetur në mësimet e Kuranit dhe traditës profetike.

Më pas, Myftiu i Sarandës, z. Bledar Mulla, mbajti një ligjëratë të shkurtër, ku u ndal në rëndësinë e përcjelljes së drejtë, të matur dhe dinjitoze të mesazhit islam, me një fokus të veçantë tek edukimi i rinisë dhe përballja me sfidat e kohës moderne. Fjalë të rastit mbajti gjithashtu edhe z. Aurel Çani, Drejtor i Kabinetit dhe Burimeve Njerëzore në KMSH, njëherazi edhe autor i këtij botimi. Në përfundim të aktivitetit, u shpërndanë certifikata vlerësimi për disa imamë dhe hoxhallarë nga e gjithë Shqipëria, të propozuar nga myftinitë përkatëse.



05 ZHVILLOHET MBLEDHJA E PARË E KËSHILLIT TË PËRGJITHSHËM PËR VITIN 2026



Këshilli i Përgjithshëm i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë zhvilloi ditën e shtunë mbledhjen e parë për vitin 2026, në ambientet e Medresesë së Tiranës.

Mbledhja u çel me leximin e disa ajeteve nga Kurani Famëlartë nga Myftiu i Tiranës, z. Gazment Teqja, për të vijuar më pas me fjalën hapëse të Kryetarit të Këshillit të Përgjithshëm, z. Islam Hoxha, i cili u uroi mirëseardhjen anëtarëve dhe i njohu ata me rendin e ditës.

Më pas, fjalën e mori Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Bujar Spahiu, i cili falënderoi anëtarët për angazhimin dhe kontributin e tyre, si dhe bëri një përmbledhje të disa prej pikave kryesore që çdo përfaqësues i institucionit duhet të ketë parasysh gjatë komunikimit me besimtarët dhe në publik, duke theksuar rëndësinë e etikës, përgjegjshmërisë dhe përcimit korrekt të mesazhit islam.

Kancelari i KMSH-së, z. Fejzi Shaholli, paraqiti më pas një raport të detajuar mbi veprimtarinë e Kryetarit, aktivitetin e drejtorive dhe vendimet e kryesisë mes dy mbledhjeve.

Më tej, drejtori i Financave, z. Edison Hoti, prezantoi para anëtarëve auditin e zhvilluar nga një ekspert i jashtëm në disa myftini, duke nxjerrë në pah pikat kryesore të këtij auditimi dhe sugjerimet për përmirësim. Më pas, drejtori i Marrëdhënive me Publikun dhe Median, z. Ejup Lila, prezantoi disa nga zhvillimet më të fundit të aktivitetit online të institucionit, si aplikacionin zyrtar të KMSH-së (kërko "KMSH" në App Store dhe Play Store), ueb-faqen e re kmsh.al, sistemin e kohëve të namazit namaz.kmsh.al.



NDJENJA E vetëllogarisë



Një rrugëtim i përkohshëm është jeta e njeriut në këtë botë. Një jetë e paqëndrueshme midis kënaqësisë dhe dhimbjes, gëzimit dhe hidhërimit, begatisë dhe varfërisë. Dhe vetë njeriu mes jetës dhe vdekjes. Njeriu u krijua dhe erdhi në ekzistencë nga balta, prej kësaj toke në një rënë anë dhe prej shpirtit, frymës hyjnore në anën tjetër që do ti jepte jetë, dhe kuptim qenies së njeriut. Ndaj edhe jeta e njeriut në këtë botë është gjithmonë mes tokës dhe qiellit, shpirtit dhe trupit, joshjeve të kësaj bote dhe bukurive shpirtërore. Gjatë këtij rrugëtimi ai ka prirjen të lidhet më fort me tokën, të mbytet në pamjen e materies, të joshet nga iluzionet e kësaj bote duke harruar Krijuesin, natyrën dhe thelbin e tij, realitetin dhe qëllimin e vërtetë të kësaj jete në këtë botë. Ndaj në çdo moment apo gjendje njeriu ka nevojën ekzistenciale të kthehet vetes së tij për të njohur dhe kujtuar edhe një herë natyrën e tij dhe qëllimin e ardhjes në ekzistencë. Për tu përballur me nefsën dhe bërë llogarinë e vetes së tij. Pikërisht një nga ndjenjat më thelbësore që shpirti i njeriut të frymojë është ndjenja e vetëllogarisë. Hz. Omer, i cili ishte një shembull i përkryer i vetëllogarisë do të thoshte: "Llogariteni veten para se

të llogariteni, sepse kështu është më lehtë për llogarinë tuaj të nesërme. Peshoni veten para se të peshoheni dhe zbkurohuni me vepra të mira për Paraqitjen e Madhe."

Nëse vdekja është realiteti më i madh i jetës njerëzore, po aq edhe llogaria për veprat e tij është një realitet i pashmangshëm që çdo njeri do të përballet një ditë. Kështu pasi që njeriu nuk mund të shmanget një realiteti të vërtetë sa vetë jeta e tij, ai duhet të shqetësohet që në këtë botë për llogarinë e tij në jetën e përtejme që të prezantohet në formë më të mirë, me pamjen më të pastër dhe me shpresën te Mëshira e Zotit të jetë prej të lumturuarve. Zoti na drejtohet në kështu në Kurandin Famëlartë:

"O ju që keni besuar, frikësohuni Allahut dhe secili le të shikojë se çka ka bërë për nesër. Frikësohuni Allahut! Me të vërtetë All-llahu është i ditur se çka punoni. Mos u bëni si ata që e harruan Allahun dhe Ai i bëri të harrojnë vetveten. Ata janë të mbrapshtë."

Rrugëtimi i gjatë i njeriut në këtë botë të përkohshme, tërësia e veprave të tij shikojnë drejt jetës së përherëshme dhe llogarisë para Zotit të Tij. Kurani Fisnik në tërësinë e

mësimeve të tij nga universi te qeniet mikroskopike, nga qytetërimet dhe shoqëritë njerëzore te ndjenjat më të holla dhe të brishta të njeriut shikojnë drejt përmirësimit të vetes, pastrimi të zemrës dhe arritjes së virtyeteve të larta. E nëse njeriu harron Zotin, bindjen ndaj tij, ndjenjën dhe vetëdijen e llogarisë së shpirtit ai do të zhytet në qorrsokakun e mëkateve duke harruar kështu veten, natyrën e tij dhe në errësirën e kësaj bote rrugën drejt lumturisë së përjetshme.

Njeriu është një qenie që harron, rrëshqet, bie në gabim duke e harruar urdhërin e Zotit të tij. Por nëpërmjet vetëllogarisë ai kthehet te vetja, kupton gabimin dhe përulet plot fajësi, drojë, frikë dhe respekt para Madhështisë së Krijuesit të tij. Ndaj vetëllogaria është një dinamikë shpirtërore e tillë që njeriun e kthen drejt Zotit, kërkimit të faljes dhe pendesës për gabimet e tij.

Vetëllogaria është një dinamikë e rëndësishme nëpërmjet të cilës njeriu përpiqet të njohë veten, gabimet e tij me qëllim përmirësimin e vetvetes. Në një shoqëri ku çdo njeri merret me veten e tij, përpiqet të gjejë gabimet te vetja do të ketë harmoni, mirësi dhe bekim prej Zotit. Në të kundërt nëse njeriu gabimet dhe përgjegjësitë përpiqet ti shikojë te të tjerët, pa e kuptuar ai do zhytet në batakun mëkateve të tij. Dhe një shoqëri e tillë nuk arrin të gjejë asnjëherë paqen dhe qetësinë.

Në veprat klasike të islamit, vetëllogarinë e gjejmë në fillimet e virtyeteve mbi pastrimin e zemrës. Ajo është një adhurim thelbësor për ti hapur më pas rrugën virtyeteve më të lartë në rrugën e lartësisë së shpirtit. Vetëllogaria është një fllad prej pafundësisë së botës hyjnore për shpirtin njerëzor. Porsi një shi pranveror për mendjen, ajo e pastron atë prej mendimeve të këqija, iluzioneve që lundrojnë në pakuptimësi për të njohur edhe njëherë veten dhe kuptimin e jetës së tij. E nëse njeriu i shmanget vetëllogarisë e vetes ai do të bëjë llogarinë e të tjerëve. Sa më shumë të ecë dhe të përparojë në këtë moçal aq më shumë do të harrojë veten dhe rrugën e tij, aq më shumë do zhytet shkujdesje, mëkatet dhe gabimet e tij.

Nëse do shfletojmë lutjet e njerëzve të mëdhenj, dijetarëve, evlijave, dhe njerëzve të dashur të Zotit do shikojmë një përvuajtje dhe qortim të atillë të egos, sikur ata të ishin gabimtarët më të mëdhenj. Sepse njeriu sa më shumë njeht Zotin, madhësinë dhe Mëshirën e Tij aq e kupton edhe padenjësirën e tij dhe përulet plot drojë dhe respekt përpara madhështisë së Tij. "Një ditë prej ditësh Hz.Ebu Bekri do të shikonte një zog në degën e një pemë dhe do të thoshte: Sa me fat je ti o zog i dashur. Ndalesh në degën e një peme, shijon nga frutet e saj e më pas fluturon dhe largohesh. Nuk ka as llogari as dënim. Ah sikur të isha si ty" Padyshim që Hz. Ebu Bekri ishte njeriu më i afërt i Profetit a.s, njeriu imani i të cilit peshonte më shumë se i gjithë umeti por kjo ishte shprehja e përvuajtjes së tij si qenie njerëzore. Ashtu sikurse Hz. Dhërri nën peshën

e të njëjtës ndjenje dhe përgjegjësie do të thoshte: "Ah sikur të isha një pemë e shkullur nga rrënjët dhe e prerë copë-copë..."

Një nga konceptet dhe gjendjet shpirtërore që lidhet ngushtë me vetëllogarinë është murakabeja. Murakabe do të thotë që njeriu në çdo moment të jetës së tij të jetojë me vetëdijen, ndjenjën dhe kujdesin e vëzhgimit të Allahut. Dhe si rrjedhojë të ndërtojë jetën sipas parimeve hyjnore. Në çdo gjë të kërkojë kënaqësinë e Allahut. Ti mbyllë dyert e zemrës nga çdo gjë që hidhëron atë. Dhe ta hapë zemrën deri në pafundësi për bukuritë e Tij. Kështu njeriu nëpërmjet vetëllogarisë së tij, përballjes me egon, njohjen e gjendjes shpirtërore mund të arrijë gjendjen që në çdo moment përjetojë murakabenë. Imami i madh Ebu Hanife në një lutje të gjatë, pasi madhëron Allahun me Cilësitë dhe Emrat e Tij më të bukur do të shprehej kështu:

"I Lartësuar dhe pa të meta është Ai që mua më shikon
Në çdo kohë e vend më vëzhgon

Gjithmonë Më furnizon dhe kurrë nuk më harron"

Një nga shqetësimet ekzistenciale që e ka shoqëruar qenien njerëzore përgjatë historisë dhe veçanërisht në kohën tonë është çështja e lumturisë, natyra e saj dhe lidhja me entitetet e tjera. Shpeshherë për të gjetur lumturinë, nëpërmjet motivimit, optimizmit dhe qasjes pozitive mbi jetën, njeriu ynë mësohet që harrojë të shkuarën, të harrojë gabimet, të falë veten e tij, ta mendojë veten si më të mirë dhe të aftë dhe që me fuqinë e tij mund ta arrijë gjithçka. Por vallë cili është përfundimi i një rruge ku njeriu refuzon të njohë veten dhe origjinën e tij. Vallë a mund të bëhet njeriu i mirë dhe të arrijë lumturinë kur në çdo përballje ai largohet nga vetja dhe të vërtetat e tij? A bëhet njeriu i virtytshëm duke e bindur veten se është i tillë?

Rruga e njeriu drejt lumturisë kalon nëpërmjet virtyeteve të larta dhe lumturia e vërtetë mund të arrihet në formën e saj më të lartë vetëm në botën e përtejme. Kësisoj lumturia nuk është një gjendje emocionale dhe psikologjike e momentit që mund të arrihet si pasojë e motivimeve të caktuara. Ajo është një gjendje që varet nga pjekuria shpirtërore e njeriut. Dhe sipas pjekurisë shpirtërore njeriu arrin të perceptojë dhe përjetojë lumturinë në jetën e kësaj bote. Kështu njeriu arrin të jetojë në paqe me shpirtin e tij.

Në fund duhet të theksojmë se, ashtu sikurse në çdo gjë në këtë jetë edhe në çështjen e vetëllogarisë njeriu duhet të ndjekë një rrugë të mesme dhe balancuar. Çdo njeri e bën vetëllogarinë sipas përkushtimit, devotshmërisë dhe nivelit të jetës shpirtërore në rrugëtimin e edukimit të vetvetes. Përndryshe një vetëllogari e ngarkuar me pesimizëm, e shkëputur nga realiteti i jetës së një njeriu mund të mos japë frytet dhe për më tepër të jetë e dëmshme për të. Profeti a.s do të thoshte: "Feja është lehtësi. Kushdo që e vështirëson atë, është i destinuar të mposhtet prej saj."

CILAT JANË KRITERET PËR TË DALË IMAM NË NAMAZ? DHE SI ËSHTË RADHA?

Kushtet bazë që një person duhet të plotësojë për të dalë imam janë:

- Të jetë mysliman.
- Të jetë mashkull.
- I rritur dhe i shëndoshë mendërisht.
- Të dijë përmendësh mjaftueshëm Kuran sa për namaz.
- Të jetë i saktë në leximin e Kuranit.
- I drejtë në fe (jo i njohur për mëkate të hapura).

Kriteret e radhës për të dalë imam janë shprehur kështu në hadithin e Profetit Muhamed (s.a.s.):

يَوْمَ الْقَوْمِ أَقْرَوْهُمْ لِكِتَابِ اللَّهِ، فَإِنْ كَانُوا فِي الْقِرَاءَةِ سَوَاءً، فَأَعْلَمُهُمْ
 بِالسُّنَّةِ، فَإِنْ كَانُوا فِي السُّنَّةِ سَوَاءً، فَأَقْدَمُهُمْ هِجْرَةَ، فَإِنْ كَانُوا فِي الْهَجْرَةِ
 سَوَاءً، فَأَقْدَمُهُمْ سِلْمًا، وَلَا يُؤَمِّنُ الرَّجُلُ الرَّجُلَ فِي سُلْطَانِهِ، وَلَا يَقَعْدُ فِي
 بَيْتِهِ عَلَى تَكْرِمَتِهِ إِلَّا بِإِذْنِهِ. [وفي رواية] مَكَانَ سِلْمًا: سَنَا

“Le t’u prijë njerëzve në namaz ai që e lexon më mirë Librin e Allahut. Nëse janë të barabartë në lexim, atëherë ai që e njeh më mirë Sunetin. Nëse janë të barabartë në Sunet, atëherë ai që ka bërë më herët hixhretin. Nëse janë të barabartë edhe në hixhret, atëherë ai që ka hyrë më herët në Islam. Dhe askush të mos i prijë një tjetri në vendin e tij të autoritetit (aty

ku ai është zot shtëpie apo ka përparësi), dhe të mos ulet në vendin e tij të nderit në shtëpinë e tij pa lejen e tij. [Në një transmetim tjetër] në vend të fjalës “islaman” (hyrje më e hershme në Islam), ka ardhur fjala “sinnen”, që do të thotë: më i moshuari.” (Muslim, h.nr. 673)

Kriteret e radhës kanë këto kuptime:

1. Ai që lexon më mirë Kuranin

- Më i saktë në lexim (texhvid) më i fortë në memorizim

2. Ai që ka më shumë dije për Sunetin

- Njohuri më të thella fetare kupton më mirë rregullat e namazit

3. Ai që ka bërë hixhret më herët

- Në kohën e sahabëve i jeper përparësi atij që ka bërë më herët hixhret, kurse sot kjo mund kuptohet si më i qëndrueshëm në fe.

4. Ai që është më i hershëm në Islam ose më i moshuar.

Allahu di gjithçka më së miri. /insi.al



Foleja më e rëndësishme e shoqërisë është *familja*



Familja nis me një burrë dhe një grua, pastaj plotësohet në mënyrën më të dëshiruar me fëmijët. Ajo është sistemi më i vjetër shoqëror, sepse arrin deri te familja e parë e Ademit (paqja qoftë mbi të), e cila ishte bërthamë e tërë shoqërisë njerëzore. Ndër qëllimet dhe funksionet e familjes, gjejmë vazhdimësinë e brezave.

Familja është një komb i vogël, kurse kombi, një familje e madhe. Kombi formohet prej elementeve në shtëpi. Kështu, po qe se shtëpitë janë mirë, edhe kombi është mirë, si dhe e kundërta. Në këtë drejtim, familjet e ngritura mbi logjikën dhe gjykimin, duke u mbështetur qysh në hapat e para te Zotit, sigurojnë vazhdimësinë e kombit që i përkasin, si dhe vënë në garanci qetësinë dhe lumturinë e brezave të ardhshëm.

Allahu në Kuran urdhëron e thotë: **“O njerëz! Frikësojuni Zotit tuaj, i Cili ju krijoi prej një njeriu, ndërsa prej atij krijoi bashkëshorten e tij, kurse prej këtyre të dyve krijoi shumë meshkuj e femra...”** (Kuran, 4:1)

يَا أَيُّهَا النَّاسُ اتَّقُوا رَبَّكُمُ الَّذِي خَلَقَكُمْ مِنْ نَفْسٍ وَاحِدَةٍ وَخَلَقَ مِنْهَا زَوْجَهَا وَبَثَّ مِنْهُمَا رِجَالًا كَثِيرًا وَنِسَاءً ۚ وَاتَّقُوا اللَّهَ الَّذِي تَسَاءَلُونَ بِهِ وَالْأَرْحَامَ ۚ إِنَّ اللَّهَ كَانَ عَلَيْكُمْ رَقِيبًا

Ashtu siç Krijuesi caktoi Ademin dhe Nuhun si zanafillës të individualitetit njerëzor dhe besimit të kulluar, po ashtu Allahu i Gjithëditur përzgjedhi mes njerëzisë familjen e Ibrahimit dhe familjen e Imranit, si përfaqësueset më të mira të modelit të familjes – fole e besimit. (Kuran, 3:33-34) Ato janë familje tërësisht besimtare, që shërbejnë me përkushtim për fenë e Zotit dhe që janë përkujdesur e kanë lënë pasardhës të kapur fort pas besimit të pastër. Ismaili, Is'haku, Jakubi, Jusufi dhe Isai, (paqja e Zotit qoftë

mbi ta) qenë disa nga Lajmëtarët e dalluar, pasardhës të këtyre dy familjeve të nderuara.

Përmes ajeteve kur'anore, që përshkruajnë copëza domethënëse nga jeta e këtyre dy familjeve, Allahu na orienton në rrugën më të mirë të modelimit hap pas hapi të një foleje familjare të shëndetshme. I Gjithëdituri, nëpërmjet Kuranit, na përkujton lutjet e shumta të profetit Ibrahim apo edhe të bashkëshortes së Imranit, për të na mësuar se prindërit, që në krye të herës dhe vazhdimisht, duhet t'i luten me sinqeritet Lutjepranuesit Allah për fëmijët. Lutjet duhet të jenë si për zhvillimin shpirtëror individual e familjar, ashtu edhe për përparimin material e civilizues. **“Zoti ynë! Na bëj të dyve (babë e bir) besimtarë të sinqertë ndaj Teje dhe nga pasardhësit tanë njerëz të bindur ndaj Teje. Na i mëso rregullat e adhurimit dhe na fal. Vërtet Ti je që fal shumë dhe je Mëshirues!”** (Kuran, 2:128) **“Zoti im! Bëje këtë një qytet të sigurt dhe më mbro mua e bijtë e mi nga adhurimi i idhujve!”** (Kuran, 14/35) **“Zoti im! Më dhuro mua (fëmijë) prej punëmirëve!”** (Kuran, 37:100) Kështu lutej, ndër të tjera, profeti Ibrahim (a.s.). Të njëjtën esencë besimi përmbante edhe lutja e gruas së nderuar të Imranit për foshnjën ende të palindur (Merjemen): **“Zoti im! Këtë që është në barkun tim, vendosa ta kushtoj vetëm për shërbimin Tënd. Pra, pranoje këtë prej meje!”** (Kuran, 3:35)

Feja Islame shumë shpesh fokusohet te rëndësia e familjes dhe e konsideron atë si kala mbrojtëse përballë jetës boheme, sepse familja është vendi ku natyra njerëzore mund ta shprehë veten në mënyrën më të mirë, ku mund t'i realizojë dhe kthejë në praktikë vlerat e larta si:

dashuria, respekti, dhembshuria, sakrificë, besnikëria dhe bindja. Afërsisht një e treta e rregullave juridike të Kuranit kanë të bëjnë me familjen dhe rregullimin e harmonisë së saj.

Sistemi i familjes Islame i vendos të drejtat e burrit, gruas, fëmijëve dhe të afërmeve në një ekuilibër të përsosur dhe këto marrëdhënie nga aspekti juridik dhe moral janë të shpjguara deri në detajet më të imëta. Ai ushqen tek individi bujarinë, dashurinë dhe sjelljet joegoiste në kuadrin e një familjeje të organizuar mirë. E gjithë kjo, ka për qëllim që shoqëria myslimane të ndërtohet mbi themele të shëndosha, pasi qetësia dhe siguria e ofruar nga një familje e stabilizuar, ka vlerë të jashtëzakonshme dhe është thelbësore për anëtarët e saj. Pa ekzistencën dhe përkrahjen e një familjeje të shëndoshë, nuk mund të realizohet harmonia në një shoqëri.

Tashmë të gjithë e pranojmë se familja shqiptare po pëson transformime strukturore dhe konceptuale. Shikojmë e përjetojmë sfidat, problemet dhe sëmundjet e saj, që drobitin dhe çojnë drejt vdekjes një e nga një qelizat vitale të kombit. Përkundër shumë e shumë problemeve, duhet theksuar se kurrësi nuk mund të vihet në pikëpyetje ekzistenca e familjes, si njësi bazë e shoqërisë njerëzore. Zhvillimi i njerëzimit është projektuar dhe ndodh vetëm mbi strukturën familjare. Ky është një nga ligjet e Allahut.

Të gjitha fetë dhe të gjithë sociologët, pavarësisht besimit dhe rrymave të mendimit filozofik, janë të unifikuar në domosdoshmërinë e njësisë familjare, të bazuar në dy gjinitë biologjike: burrë dhe grua. Kjo është sanksionuar me konsensus ndërkombëtar si në

Deklaratën e Përgjithshme mbi të Drejtat e Njeriut, ashtu edhe në Kodet e Familjes që aplikohen në sistemet juridike të të gjithë shteteve në botë.

Familja e ngjizur nëpërmjet besimit në Zot përbën modelin më të natyrshëm, më të përshtatshëm e më të konsoliduar për të siguruar vazhdimësinë e shoqërisë njerëzore. Historia e gjatë e njerëzimit e ka dëshmuar më së miri këtë. Më së pari, prindërit duhet të mbushen me besim në Zotin Krijues, Mëshirues e Bamirës. Pastaj, ata duhet ta falënderojnë pareshtur Allahun për dhuratën e çmuar jetësore. Dhe, pa rënë në harresë e neglizhencë, këtë besim të natyrshëm duhet t'ua transmetojnë me mençuri edhe fëmijëve përgjatë procesit të edukimit.

Feja islame ka për qëllim të krijojë familje të shëndosha në shoqëri. Këto familje të shëndosha nuk mund të shkatërrohen lehtë dhe nuk bien lehtë nën ndikimin e streseve shoqërore dhe morale. Që mos shkojmë deri te shkatërrimi i familjes prej shtresave ideologjike, të cilat mundohen të depërtojnë në familjet tona, ne duhet ta mbrojmë dhe ta forcojmë vazhdimisht strukturën familjare.

Lusim Allahun (xh.sh.) të na ndihmojë në rrugën e përçimit të vlerave fetare e morale, në kuadër të ruajtjes së dinjitetit të lartë njerëzor, si dhe të na ruajë familjet tona e familjet e reja që krijohen nga të gjitha rreziqet që i kanosen shoqërisë shqiptare. Zot, bëje sistemin e pastër të vlerave fetare, bashkë me shembullin e lartë të moralit të profetëve, e në veçanti atë të Profetit Muhamed (a.s.), sistemin triumfues për ngritjen e vlerave njerëzore drejt horizonteve të larta, dhe ruana ndaj çdo ideje të paqenë e që në thelb ka cytje djallëzore dhe shthurjen e prishjen!



SËMUNDJA E VETËPËLQIMIT

Të flasësh për veten gjatë gjithë kohës – me fjalë të tjera, të bësh gjëra për të tërhequr vëmendjen te vetja dhe për t’u bërë përshtypje të tjerëve – është një dobësi karakteri. Sigurisht, ka raste kur dikush duhet të shprehet. Për shembull, lutja është një kohë kur dikush qëndron përpara Allahut dhe shpreh ndjenjat e tij të brendshme tek Ai.

Njeriu është një kryevepër e Krijuesit; çdo njeri mbart linja dhe modele që tregojnë Artistin që i krijoi ato. Njeriu, sipas fjalëve të Bediuzamanit, është një tregues i gjithë ekzistencës. Kur e shqyrtojmë thellë njeriun, mund të dëshmojmë se sa krijim i mrekullueshëm është, sa unik është me arsyen, shpirtin, zemrën, vullnetin, ndërgjegjen dhe ndjenjat e tij. Ajo që pritet nga njeriu është të njohë burimin e të gjitha këtyre cilësive, të jetë mirënjohës ndaj Atij, të lavdërojë Madhërinë e Tij dhe t’i drejtohet Atij me vetëdije të plotë për të qenë shërbëtor. Ajo që kërkohet nga një shërbëtor është që ai të pranojë pozicionin e tij përballë Hyjnes dhe që gjithçka që zotëron në fakt i përket Pronarit të tyre të vërtetë. T’i shprehesh Zotit me një vetëdije të tillë është vetëm e shumë e lavdërueshme.

Ajo që nuk është e lavdërueshme është kur një person përpiket të dalë përpara në çdo rast për të tërhequr vëmendjen ndaj vetes me qëndrimin, sjelljen, mendimet, madje edhe me lutjen dhe adhurimin e tij, në mënyrë që të arrijë admirimin e të tjerëve. Ajo që në fakt bën një person kur ai ose ajo shfaqet me virtytet dhe kualifikimet e tyre është se harrojnë burimin e tyre të vërtetë dhe pretendojnë pronësinë e tyre. Ata, si të thuash, po konfiskojnë atë që në fakt i takon Zotit, pavarësisht nëse e dinë apo jo.

Ata që ndjekin me mendjemadhësi admirimin dhe duartrokitjet bëjnë gjithmonë lloj-lloj kthesash dhe manovrash me qëllimin që biseda të qarkullojë rreth tyre. Kur flasin ose shkruajnë, nënkuptojnë cilësitë e tyre të vetëshpallura, nëse nuk mund ta bëjnë atë drejtpërdrejt. Ata do të prodhonin art vetëm për t’u treguar të tjerëve se si duhet të duket arti; kur ata shkruajnë diçka, të gjithë duhet ta lexojnë dhe ta lavdërojnë atë – ata nuk do të mirëprisnin kritika negative. Nëse ndodh që ata të përmendin emrin e Gjithëlavdëruar të të Plotfuqishmit, Allahut, ata do të kërkonin madje ndonjë meritë për këtë. Kur ata japin leksione nga foltore për Zotin, ajo që ata kërkojnë në të vërtetë është të tregojnë se sa të talentuar janë për xhematin. Ja pse e ngrënë zërin; kjo është arsyeja pse ata godasin minberin ndërsa flasin.

Mënyra e tyre e jetesës, makinat, shtëpitë, çdo objekt që përdorin është një mjet që ata të flasin për veten e tyre. Ndërsa e bëjnë këtë, ata arrijnë të kamuflojnë paraqitjet e tyre – ndonjëherë edhe me një përlulësi artificiale.

Këta njerëz të sëmurë nga tregimi i vetes, gjithmonë dëshirojnë që të tjerët të flasin për ta. Përpjekjet e tyre nuk mjaftojnë me aq; ata mbajnë njerëz të tjerë pranë tyre për të brohoritur për ta; ata madje mund të ndërtojnë institucione vetëm për të marrë merita. Konferencat apo librat që nuk përmendin emrin e tyre nuk kanë asnjë vlerë në sytë e tyre.

Këta të “varfër” janë gjithashtu shumë xhelozë. Ata janë jashtëzakonisht të shqetësuar kur të tjerët lavdërohen. Ata mund të thonë se sa shumë e admirojnë dikë në fytyrë, por pas shpine, ata komplotojnë për ta poshtëruar atë. Ata nxjerrin në pah pikat e dobëta të të tjerëve, kështu që vlera e tyre mund të shkëlqejë më shumë. Ata gërmojnë tokën rreth tyre, në mënyrë që të qëndrojnë më lart vetë. E gjithë kjo sjellje nuk të çon askund veçse në katastrofë.

Nënshtimi i egos dhe ushtrimi i pushtetit të vullnetit

Cilësitë tona më të mira janë të gjitha nga Zoti. Mund të kemi një karrierë të jashtëzakonshme, njohuri të mëdha, pasuri të madhe dhe aftësi të panumërta; ne mund t’i kemi të gjitha këto vetëm nëse përdorim atë që na ka bekuar Allahu dhe nëse Ai na hap shtigjet. Nga ana tjetër, nëse shtrojmë pyetjen, a po nxjerrim më të mirën ne nga këto bekime të dhuruara në mënyrën më efikase të mundshme, sigurisht nuk është një pyetje e lehtë për t’iu përgjigjur.

Të gjitha këto aftësi dhe cilësi duhet të përdoren jo për të folur për veten, por për të folur për Atë që na ka dhënë zërin dhe fjalët. Nga pamja dhe paraqitja jonë duhet të nxjerrim kuptime për të Plotfuqishmin. Kur flasim, duhet të themi fjalë të dijes dhe dashurisë hyjnore. Ata që dëgjojnë duhet të rriten në entuziazëm në lidhje me Allahun. Çdo fjalim yni duhet të jetë si një lutje për veçantinë e Tij.

Shpëtimi i vetes nga kjo sëmundje varet nga “zvogëlimi i vetvetes në zero” – me fjalë të tjera, duke zhvilluar karakterin e përlulësisë. Kjo është e mundur me një vetëdisiplinë të ruajtur për një kohë të gjatë. Përlulësia nuk është e lehtë të përvetësohet në natyrën e dikujt, por njeriu duhet ta detyrojë veten në të. Sëmundja e vetëpëlqimit lidhet me vullnetin tonë; kështu është edhe përpjekja për ta parandaluar atë. Vetëm duke



ushtruar disiplinë mund të ndryshojmë karakterin tonë në planin afatgjatë.

Një besimtar i vërtetë duhet të varrosë nën tokë të gjitha manifestimet e vetë-admirimit – t'i varrosë ato thellë dhe t'u vendosë gurë përsipër. Kjo është ajo që ka të bëjë më herët edhe me traditat mistike. Njerëzit në shkollat përkatëse të mistikës Islame mësoheshin se si ta vinin nën kontroll shpirtin e tyre trupor. Praktikant e tërheqjes shpirtërore si agjërimi dhe përpjekja në rrugën e drejtë, kanë për qëllim t'i çlirojnë njerëzit nga tiparet e egoizmit dhe arrogancës, në mënyrë që ata të mund të zbulohen me karakter të bukur – për t'i bërë ata të ndjekin provat e njohurisë hyjnore (marifetullah) dhe të arrijnë ta njohin dhe ta duan Atë (muhabbetullah). Këto praktika i ndihmuan ata të pranojnë se gjithçka është prej Tij dhe të kuptojnë madhështinë e Tij kundrejt asaj sa të vegjël jemi ne.

Megalomania

Mjerisht, njerëzit nuk po i nënshtrohen ndonjë edukimi të tillë shpirtëror në kohët tona. Egot nuk pastrohen, zemrat nuk pastrohen. Shpirtat e trupëzuar nuk mund të vihen nën kontroll. Në vend që t'i zbutin zemrat e tyre, shumë njerëz e bëjnë veten "bishën" që kalërojnë shpirtat e tyre të trupëzuar. Kjo mund të konsiderohet si në nivel individual ashtu edhe në atë shoqëror. Një sëmundje e tillë mund të përhapet lehtësisht midis anëtarëve të një kombi ose komuniteti që e konsideron veten si një grup legjendar heronjsh. Lidhja me një komunitet, anëtarësimi në një shkollë mendimi, një institucion, një universitet, madje edhe në një profesion

mund të fryjë egon e njerëzve dhe t'i bëjë ata ta shohin veten si superiorë, ndonjëherë pa qenë të vetëdijshëm për këtë situatë. Ata gjithmonë flasin për legjendat dhe heroizmat e tyre. Kjo mund të arrijë një pikë ku ata bëhen megalomanë, por duke qenë se të gjithë në komunitet janë të dobësuar me të njëjtën sëmundje, asnjëri prej tyre nuk vëren asgjë.

Të gjitha këto simptoma tregojnë praninë e një sëmundjeje në shpirt. Ndërsa trupi ynë sëmurët, po ashtu edhe shpirti ynë sëmurët. Sëmundjet në shpirt janë më të vështira për t'u kuruar sesa në trup, duke kërkuar më shumë kohë dhe përpjekje. Për t'i shëruar ata, njerëzit duhet të konsultohen si me psikologë ashtu edhe me mësues shpirtërorë, të cilët mund të jenë në gjendje të shohin me dritën e besimit dhe të zbulojnë pikat e dobëta.

Çdo njeri është krijuar me boshllëqe të tilla në shpirtin e tij. Këto boshllëqe mund të lejojnë që të rriten ndjenjat si dukja dhe krenaria. Këto janë artikuj testues në gjendjen njerëzore. Megjithatë, burimet e këtyre ndjenjave janë në fakt të hapura si për të mirën ashtu edhe për të keqen. Ajo që duhet të bëjmë është të jemi të kujdesshëm ndaj prirjeve drejt së keqes, të përpiqemi të nënshtrojmë atë që shfaqet si e keqe dhe të punojmë shumë për të kanalizuar të gjithë potencialin tonë drejt së mirës. Ata që mund ta zvogëlojnë veten në zero me fuqinë maksimale të vullnetit të tyre dhe të pastrojnë shpirtat e tyre, mund të zotërojnë ekzistencën e tyre në këtë jetë./ fountainmagazine

Gruaja

ZEMRA E FAMILJES DHE SHOQËRISË

Islami, kjo fe madhështore, na mëson gjithçka. Na mëson si të jetojmë, si të duam njerëzit por mbi të gjitha na mëson si të duam veten. Me Kuranin, manualin jetësor të njeriut këtë udhërrëfyes të përjetshëm, njeriu kupton sa pak di dhe sa shumë ka për të mësuar. Në gjithë këtë madhështi dhe mirësitë e pafundme që Zoti ka vendosur në tokë, i ka dhuruar njerëzimit pjesën më të bukur të shoqërisë dhe epiqendra e kësaj bote, e cila është gruaja.

Në cdo dimension të saj, si grua, nënë, si bijë, si bashkëshorte, në çdo stad të jetës së saj, ajo është kurora e kësaj bote. E bukur në shpirt, e ndjeshme, e dashur dhe e fortë përballë çdo sprove që i sjell jeta, ajo përpiqet të qëndrojë e fortë dhe dinjitoze, ashtu siç i ka hije.

Në ditët e sotme është bërë shpesh përpjekje për ta zbehur figurën e saj.

Por Islami e ngriti gruan që para 1400 vitesh, në një kohë kur ajo nuk kishte vlerë në sytë e shoqërisë.


Sot, gruaja mbetet thelbi i gjithçkaje.

Mes sfidave të epokës moderne, ritmit të shpejtë dhe teknologjisë që zhvillohet çdo ditë, ajo vazhdon të qëndrojë stoike, duke balancuar jetën, familjen dhe fëmijët.

Ashtu si një fëmijë që hedh hapat e parë me frikë se mos rrëzohet, edhe ajo ecën përpara çdo ditë, me kujdes, por me forcë të brendshme duke ruajtur qëndrueshmërinë dhe ekuilibrin në çdo sfidë që i sjell jeta.

Bota ka ndryshuar, çdo gjë ecën me ritme të shpejta dhe shpesh ajo ndjen presion nga të gjitha anët.

Mes telefonit, rrjeteve sociale dhe angazhimeve të përditshme, ajo përpiqet të mos humbasë veten.



Si nënë, mundohet të rrisë fëmijë të hajrit në një kohë që nuk është aspak e lehtë.

Ajo përpiqet t'u mësojë fëmijëve vlerat, respektin dhe dashurinë për Zotin në një botë ku shpesh e mira dhe e keqja ngatërrohen.

Frikësohet për zemrat e tyre, për edukimin e tyre dhe për rrugën që ata do të ndjekin në të ardhmen.

"Shpesh, askush nuk e sheh lodhjen e saj të vërtetë. Ajo lodhet në heshtje, lutet në heshtje dhe vazhdon në heshtje. Por Zoti i sheh të gjitha sakrificat që zemra e saj mban çdo ditë."

Ajo nuk dëshiron vetëm t'i ushqejë e t'i rrisë, por të lërë tek ata moral, besim dhe mirësi sepse e di se fëmijët nuk rriten vetëm me fjalë, por me shembullin që shohin çdo ditë tek nëna e tyre.

Si bashkëshorte, përpiqet të mbajë familjen të bashkuar me durim dhe dashuri.

Nuk është gjithmonë e fortë, lodhet, mërzitet... por prapë çohet dhe vazhdon.

Dhe ndoshta pikërisht këtu qëndron bukuria e saj.

Jo tek perfeksioni, por tek përpjekja e përditshme.

Pavarësisht pas gjithë forcës që tregon, ajo mbetet një zemër e ndjeshme që ka nevojë për mirësi, vlerësim dhe qetësi."

Edhe kur lodhet, ajo jep. Edhe kur mërzitet, ajo buzëqesh.

Dhe nuk është rastësi që profeti jonë e ka dhënë sihariqin e tij qysh në fillezën e jetës.

"Xheneti është nën këmbët e nënës."

Dhe në heshtje, pa shumë fjalë, ajo mban mbi supë një botë të tërë...

Puna dhe prona në optikën e fesë Islame

Feja islame, si sistem edukimi dhe mënyrë jetese, nuk kujdeset vetëm për sferën shpirtërore të njeriut, sepse duke qenë njëkohësisht një sistem praktik, përmbledh besimin, ashtu edhe jetën, ose sa vlerëson idealen, aq kërkon të përfillet dhe materialja. Brenda këtij koncepti mjaft të pranueshëm për arsyen, Islami e sheh individin gjithmonë në kompleks, e para së gjithash në marrëdhënie me njerëzit dhe i dikton atij rregullat e veta për ta ndihmuar të gjejë rrugën e drejtë, jo vetëm në aspektin individual e shpirtëror, por edhe në atë shoqëror, ekonomik e politik.

Në Kur'an njeriut i thuhet: "Unë do të vendos mëkëmbës në tokë" (2:30). Kjo barrë, të cilën e mori përsipër njeriu, e ngarkon atë me përgjegjësinë e madhe për ta bërë botën të lulëzuar në çdo aspekt. Prandaj njeriut i është dhënë aftësi e liri e plotë mendore për studimin e kësaj bote materiale, në mënyrë që, nëpërmjet punës së vazhdueshme, të kërkojë e të zbulojë çdo gjë, e cila mund ta bëjë gjithnjë e më shumë zotërues të saj. Për këtë arsye, feja islame nxit në masat e pasuesve të saj punën dhe çdo veprimtari tjetër aktive që çon në përmirësimin e kushteve të jetës. Puna konsiderohet si një aktivitet parësor, i cili ka një funksion sa moral, aq edhe material, sepse ajo është sa faktor lufte kundër mendimeve dhe pasioneve të këqija, po aq edhe faktor kundër varfërisë për të cilën profeti Muhamed a.s. ka thënë: "Varfëria e çon njeriun deri në mohim të Zotit dhe mosmirënjohje..."

Prandaj myslimanët me moshë madhore, veçanërisht ata që kanë në ngarkim familje, e kanë për detyrë të

punojnë e të përdorin aftësitë dhe burimet që i ka falur Zoti për të siguruar jetesën me mundin dhe djersën e tyre.

Islami mbështet fuqishëm devizën: "Në djersën e fytyrës tënde do të hash bukën tënde" dhe dënon papunësinë pa shkaqe madhore, përtacinë, lypjen, apo pritjen e lëmoshës prej të tjerëve, të cilat i prishin njeriut karakterin, e vënë nën varësi, duke i mohuar kështu lirinë dhe vetëveprimin. Për të evituar të këqijat që sjellin këto feja jonë nuk e këshillon dhënien e lëmoshës, përveç rasteve kur ajo jepet si ndihmë për atë që ndodhet në vështirësi të vërteta dhe jo për faj të tij. Ndihma dhe mbështetja ekonomike në këto raste, përcaktohet si detyrë e çdo myslimani. Por, dihet se askush nuk e shijon më shumë ushqimin sesa ai që e ka siguruar me djersën e vet. Prandaj Islami këshillon që myslimani të mos mendojë kurrë se mjerimi mund të shmanget duke shpresuar në ndihmën e të tjerëve. Konkretisht, sot, për shqiptarin po bëhet gjithnjë e më e qartë se asnjë individ apo shtet ekonomikisht i fortë, nuk i shpenzon paratë e tij në Shqipëri pa pasur të siguruar një përfitim material ose politik. Nga ana tjetër, pushteti i diktaturës së proletariatit i mësoi njerëzit të punojnë pak e të kënaqen me varfërinë e asaj page që i mbante gjallë, por nuk i pasuronte kurrë. E katandisi fshatarin në atë gjendje sa të kishte ushqim bazë bukën e misrit dhe gjellë dhallin ose sherbetin. Në këtë mënyrë i bëri të kuptojnë punonjësit se tani djersa e tyre e harxhuar në punë, nuk i sillte më fitimin e merituar. Kjo çoi në shmangjen ndaj punës së vërtetë dhe kultivoi tek



ata indiferentizmin ndaj punës, pastaj dembelizmin dhe për pasojë hilen e vjedhjen. I detyroi të kompensojnë nevojat e domosdoshme të jetës me vjedhjen fillimisht të çdo produkti që prodhonte dhe pastaj të çdo gjëje që ishte pronë e të gjithëve, duke e vënë kështu individin kundër shoqërisë, pasojat më të tmerrshme të të cilit i pamë gjatë kalimit të pushteteve. Të gjitha këto çuan në shndërrimin e shumë virtyteve në vese, të cilat pa dashur e gradualisht u përvetësuan dhe u shndërruan në norma dhe krijuan te shqiptari një varfëri shpirtërore nga zhveshja e shumë vlerave morale të çmuara të trashëguara nga brezat e mëparshëm.

Duke e konsideruar punën shumë të dobishme dhe moralisht të ndershme, profeti Muhamed a.s. në kohën e tij këshillonte: "Është më mirë që secili prej jush të marrë një litar dhe të ngarkohet me dru për t'i shitur sesa t'ua lypë ushqimin të tjerëve, pa marrë parasysht nëse japin ose jo". Sot, te ne, shohim jo pak të rinj e familjarë, të cilët, pa ndrojtje dhe në mënyrë të ndershme, e sigurojnë jetesën duke shitur vetëm pak produkte të konsumit të shpejtë. Por shohim njëkohësisht mjaft të tjerë, të cilët e konsiderojnë turp një veprim të tillë. Duke qëndruar kot me shokët trotuareve, në qoftë se nuk merren me gjëra imorale, më e pakta që bëjnë është përgojimi i të tjerëve, ose më keq, e vrasin kohën me lojëra të padobishme e moralisht të ndaluara. Natyrisht, është detyrë edhe e shtetit në këtë periudhë që të krijojë mundësi punësimi.

Edhe çudirat për Islamin nuk ekzistojnë si mrekulli, por krijohen nga vetë njerëzit. Më të përkryera dhe të çmuara janë vetëm ato që arrihen nëpërmjet përsosjes së mjeteve të punës e të prodhimit. Prandaj kurrë nuk duhen pritur mrekulli të cilat mund të largojnë në mënyrë të çuditshme varfërinë e atij që duke u ngrohur në diell, sheh ëndrra me sy hapur. As shpresat e gënjeshtërtat në lojërat e fatit, as bixhozi nuk e zhdukin varfërinë. Në lotari humbasin mijëra dhe fitojnë më shumë organizatorët dhe disa individë. Shpresat e vazhdueshme për disa fitore të rastit që mund të mos arrihet kurrë, të çojnë vetëm në pasivitet. Akoma më e keqe është loja e bixhozit, e cila përfundon me humbje morale e materiale të rënda. Prandaj të dyja këto Islamin i dënon dhe i ndalon.

Sot ndodh shpesh që shumë familjarë, të detyruar nga kushtet e vështira ekonomike, detyrohen të kërkojnë borxhe për të përballuar jetesën, ose për të filluar një punë fitimprurëse. Islami e lejon në të tilla raste borxhin (asnjëherë me kamatë), por këshillon që ai të evitohet sa më shumë. Marrja e borxhit, e mbështetur gjithmonë në një kontratë ku përcaktohet afati i kthimit, kur për arsye të ndryshme nuk respektohet, krijon shqetësime të forta e tensione psikologjike, jo vetëm tek individ, por për pasojë dhe në familje e shoqëri. Duke i vlerësuar shumë pasojat e borxhit, Muhamedi a.s. ka thënë: "Zoti më ruajttë prej mëkateve dhe borxheve!" Prandaj, për të ruajtur dinjitetin dhe lirinë tënde, Islami këshillon të

mos marrësh borxhe, por me punën dhe me një fitim të vogël, planifiko drejt shpenzimet.

Kush punon, fiton dhe mundet të sigurojë veç mjeteve të nevojshme të jetesës edhe pasuri, e cila në fenë islame konsiderohet një dukuri normale dhe mjaft pozitive. Por ajo përcakton kufij për atë, cakton taksa për çdo pronar, të cilat rriten në proporcion me pronësinë dhe fitimin dhe venë si detyrë parësore fetare shlyerjen e zekatit, ku çdo mysliman pastron pasurinë e tij nga teprica. Të gjitha këto vihen në shërbim të shoqërisë dhe kryesisht të të varfërve. Kërkon gjithashtu që pasuria e fituar në para të vihet në qarkullim në ato veprimtari ekonomike që favorizojnë shoqërinë dhe të mos mbahet e bllokuar në ar, etj. Pasurinë e patundshme që krijon çdo individ me punën dhe djersën e tij, feja islame e mbron dhe ndalon përvetësimin nga të tjerët edhe në ato raste kur padrejtësisht mund të bëhet në rrugë ligjore. Nuk përkrah gjithashtu idenë e privatizimit të burimeve të mëdha të pasurive shoqërore e sidomos të burimeve natyrore, duke i lënë ato në duar individësh. Ato duhet t'i shërbejnë shoqërisë, duke mbetur pronë e bashkësisë (shtetit) për t'i shërbyer të gjithë anëtarëve si bazë materiale për të mbështetur zhvillimin e sferave të ndryshme të jetës.

Nëpërmjet këtyre pikëpamjeve dhe qëndrimit shumë të arsyeshëm mbi punën dhe pronën, Islami, pa penguar lirinë e mendimit dhe veprimit individual të njeriut për të fituar të mira materiale, kërkon që këto t'i shërbejnë jo vetëm atij, por tërë shoqërisë. Duke e parë të pleksur besimin me jetën, duke e konsideruar punën e ndershme si kolona që mban në ekuilibër shpirtëroren me materialen, Muhamedi a.s. ka urdhëruar: "Çdo myslimani i është detyrimisht e shenjtë dhe e paprekshme jeta, pasuria dhe nderi i tjetrit."



SFIDA E INTEGRIMIT KULTUROR TË MYSLIMANËVE NË BOTËN PERËNDIMORE

Sipas fesë Islame, njerëzit në botë kanë origjinë të përbashkët dhe si të tillë duhet të kenë marrëdhënie vëllazërore me njëri tjetrin. Ndikimi kulturor reciprok ndërmjet popujve nxit forcimin e marrëdhënieve të shëndosha e të pandërprera midis tyre, pa i imponuar njëri-tjetrit besimin e vet.

Shekulli i XXI, me përparimin e jashtëzakonshëm të shkencës dhe teknologjisë moderne, sjell para myslimanëve sfida të mëdha. Në këtë këndvështrim, feja shihet si faktor negativ, statik dhe konservator, sepse interpretohet si e paaftë për ndryshime pasi konsiderohet me natyrë antishkencore dhe antimoderne. Kjo ndodh për faktin se kuptimi dhe përmbajtja e islamit janë reduktuar dhe interpretohen vetëm si porosi religjioze duke mos përfillur e duke mohuar rolin e tij në ndryshimin e botës që na rrethon. Për rrjedhojë ka dobësuar nga brenda forcën dhe përplekjen e bashkësisë islame. Prandaj myslimanët duhet t'i rikthehen islamit, të jetojnë si besimtarë të vërtetë të kësaj feje, të formojnë modelin e tyre të modernizimit mbi bazën e normave, vlerave dhe botëkuptimit të tyre.

Qëndrimet e myslimanëve në lidhje me jetën, gjithësinë dhe sjelljet janë nën ndikimin e besimit islam, të mendimeve kulturore e filozofike të tij. Në dallim nga

kjo, në botën perëndimore të sotme, në kuadrin e lirisë së mendimit, kanë lindur e po përhapen me shpejtësi vlera morale të kundërta që kanë burimet e tyre dhe që po e zhveshin njeriun nga çdo vlerë tradicionale.

Pra, në sfidën e myslimanëve në shek. XXI-të nuk mund të flitet në përgjithësi, por duhet të shtjellohet sipas dispozitave Hyjnore duke vlerësuar sa aktuale janë ato dhe sa përputhen me kërkesat imediate të shoqërisë njerëzore në situatën aktuale.

Një nga themelet bazë të islamit është pohimi "La ilahe il-lall-llah Muhamed resull-llah". Nuk ka Hyjni (perëndi) përveç Zotit dhe Muhamedi është i dërguari i Tij. Kjo dëshmi e myslimanit e çliron atë nga zotat e rremë, që drejtojnë jetën e tij. Me këtë përputhet edhe ajeti kuranor ku thuhet: "Mos kini frikë njerëzit, por kini frikë veç Zotin." Pra, Kurani praktikisht e ka anuluar përluljen ndaj autoriteteve dhe ka vendosur vetëm një përlulje, atë ndaj Zotit. E ka çliruar njeriun nga të gjitha përluljet, duke ndërtuar lirinë e tij të plotë. Shumë aktual mbetet mendimi islam për barazinë dhe vëllazërimin e të gjithë njerëzve pa dallim. Në Kuran thuhet: "Njerëzit janë një bashkësi, Zoti i dërgon profetin përgëzues e qartësues dhe atyre Ai u zbriti edhe librin me fakte të qarta për të gjykuar për atë që ata e kundërshtojnë njëri-tjetrin!" Do

1. Kuran, Surja Bekare, 2:213.



të thotë se të gjithë njerëzit kanë vlerë të njëjtë pa dallim race, kombësie, gjendje ekonomike apo prejardhje. Por, duke folur për aktualitetin, myslimanët janë gati të identifikojnë me këtë progresin, kulturën, arsimin, lirinë nga paragjykimet dhe mashtrimet, humanizmin dhe tolerancën.


Islami në fakt është një fe që fton drejt paqes dhe ruajtjes së rendit dhe myslimanët nuk janë njerëz që kryejnë akte dhune më shumë se çdo njeri tjetër në këtë botë të ndërlikuar. Islami duhet të gjykohet dhe vlerësohet duke u nisur nga parimet dhe mësimet e tij dhe jo nga sjellja e disa individëve të caktuar që mund të pretendojnë se janë njerëzit e vetëm që përfaqësojnë islamin. Pra, duhet bërë dallim midis asaj që predikon islami me normat dhe vlerat e tij dhe asaj që bëjnë disa individë të caktuar të cilët thonë se janë myslimanë. Feja islame nuk ua lejon njerëzve të zakonshëm të ushtrorinë ligjin islam, pasi këtë të drejtë ja jep vetëm pushtetit gjyqësor që është i specializuar dhe i ngarkuar për zbatimin e ligjeve.

Në Kuran ka thënie të qarta që bëjnë fjalë për myslimanët që të jetojnë në mënyrë paqësore me këdo, pavarësisht fesë që i përkasin. Në një thënie theksohet: "Allahu nuk ju ndalon të bëni mirë dhe të mbani drejtësi me ata që nuk ju luftuan për shkak të fesë, e as nuk ju

dëbuan prej shtëpive tuaja". Kjo do të thotë se drejtësia nuk është një kategori shoqërore apo e prodhuar, por është një kategori fetare. Kërkesat e fesë janë kërkesa në emër të Zotit dhe në interes të njeriut në përgjithësi dhe asnjëherë në interesin e një individi të privilegjuar, me pushtet, pasuri etj.

Për myslimanët çështja e lirisë së ndërgjegjes dhe tolerancës është çështje morale dhe çdo njeri duhet të kërkojë në shpirtin e vet dhe të përcaktojë se si do ta ushtrorë këtë liri. Për ata islami mbetet principi më i lartë që përcakton limitet e lirisë dhe tolerancës. Kështu, për shembull, në aktualitetin e sotëm, kur alkooli dhe droga dhe fenomene të tjera si këto kanë marrë përmasa të gjera, islami i ndalon këto dhe i dënon rreptësisht dhe për këtë myslimanët krenohen se në këtë situatë janë të orientuar drejt. Në kushtet e sotme të konfuzionit moral që ka përfshirë shoqërinë tonë, pranimi i parimit universal të vazhdimësisë së identitetit kulturor dhe traditave më të mira të popujve, shërben si orientim për gjithë shoqërinë, pa dallim gjinie e race, që të dijë të operojë si duhet në kushtet e reja bashkëkohore. Pra, kultura është ajo që ka meritën e veçantë për të krijuar lidhje, një karakteristikë që jep mundësi për të njohur, për të qenë prezent dhe për të vepruar.

Domosdoshmëria E FESË NË SHOQËRINË MODERNE



Ashtu sikurse modernizmi, qoftë si periudhë kohore apo edhe si ideologji, vuri në pikëpyetje shumëçka prej traditës historike të popujve, midis tyre nuk kurseu të vinte në pikëpyetje edhe ekzistencën e fesë dhe rolin e saj. Aq sa nuk u ngrit më të shohë rreth vërtetësisë së saj, të shkuarës së largët që në origjinë të krijimit, gjurmët e thella të pa fshira në histori, por në mënyrë direkte ngriti pyetjen, a na duhet më feja në shoqërinë dhe kohën që jetojmë? A është e domosdoshme të ndjekim modele të tilla të hershme sikurse janë fetë, apo mund të mjaftohemi me mekanizmat tanë, qoftë edhe duke e zëvendësuar fenë me ideologji të reja, që kanë në qendër rolin dhe funksionin e fesë, edhe pse të quajtura me emra që i shkojnë për shtat modernes?

Po të shohim përkufizimin e fjalës fe, ajo do të thotë ligj, traditë, metodë, bindje, rrugë që të çon për tek Zoti¹. Ndërsa kuptimi i saj terminologjik përfshin brenda funksione esenciale, të cilat deri më sot nuk ka arritur t'i plotësojë asgjë tjetër përveç fesë. Feja synon që me anë të ligjeve të diktuar nga Zoti, nëpërmjet profetëve, si model të gjallë dhe të denjë për tu pasuar, t'i drejtojë individët dhe shoqëritë drejt asaj që është e dobishme dhe kështu sigurojë atyre lumturinë e përherëshme.² Ajo i jep përgjigje pyetjeve më të qenësishme të ekzistencës njerëzore, e trajton njeriun si kurorë të krijimit, i mëson atij përgjegjësitë dhe synon përsosmërinë e tij shpirtërore.

Profeti Muhamed (s.a.s) thekson se ndjenja e fesë dhe e besimit është diçka e natyrshme për çdo qenie njerëzore dhe kjo ndjenjë vjen në jetë bashkë me vetë njeriun. Në një transmetim të njohur ai thotë: "Çdo foshnjë lind me natyrshmëri të pastër"³. E pra kjo ndjenjë lind me njeriun, e shoqëron atë në çdo fazë të jetës, kërkon ushqimin e saj dhe pa të pëson ç'orientime në botën shpirtërore. Çdo njeri ka si veçori besimin te një qenie më të lartë dhe transhedente. Përgjatë gjithë historisë njerëzore njerëzit nuk kanë jetuar asnjëherë si të pa fe, qoftë kjo e drejtë apo e gabuar.⁴

Modernizmi solli me vete edhe dukuri të tjera si sekularizmi dhe globalizmi, të cilat

në mënyrë të drejtpërdrejtë goditën fort një prej institucioneve më të rëndësishme të shoqërisë, fenë. Sekularizmi edhe pse jo duke e zhdukur tërësisht fenë, e zhveshi atë nga ndikimi dhe e largoi nga jeta qendrore e individëve dhe shoqërisë në përgjithësi. Feja nuk kishte më vend në jetën shoqërore, në vendimmarrje, por jetonte subjektivisht, vetëm në ndërgjegjen e njeriut. Sekularizmi është gjendje shoqërore ku feja, institucionet dhe botëkuptimi i saj reshtin së paturi domethënie qendrore për shoqërinë⁵. Ndërsa globalizmi sipas ekspertëve solli me vete shumë dëme, qoftë politike, ekonomike, apo edhe shoqërore.

Modernizmi kishte një qasje përjashtuese rreth kulturës dhe historisë, duke quajtur të prapambetur çdo gjë të vjetër dhe duke hyznizuar çdo inovacion të ri. Synonte kudo ku kishte ndikim, njeriun e ri të industrializuar, të zhvilluar tej mase dhe zotërues të çdo burimi tokësor, aq sa njerëzit i rritën jashtëzakonisht shumë kërkesat e tyre dhe burimet rezultonin të ishin të pamjaftueshme.

Ibn Halduni citon në veprën e tij "Mukaddime" shpërndarjen në mënyrë jo të barabartë të të mirave materiale, por thekson se njerëzit që jetojnë të ekuilibruar dhe i vendosin fre orekseve të tyre janë më të shëndetshëm dhe më të bukur fizionimisht. Pra, nëse burimet janë të bollshme duhet konsumuar maturisht për arsye shpirtërore dhe fiziologjike. Gjithashtu sipas tij ata janë më të aftë të thurin poezi, të bëjnë art dhe kështu të prodhojnë edhe kulturë⁶. Mirëpo, në botën moderne, neve na duket se gjërat janë të pakta, por konsumojmë gjithnjë e më tepër.

Feja i thyen urat midis të varfërve dhe të pasurve me anë të nxitjes dhe urdhrin për të dhuruar. Fenomenin apo problemin e varfërisë ekstreme që prek një pjesë të konsiderueshme të shoqërisë e trajton si shfrytëzim pa kriter të një pjese njerëzish ndaj pjesës tjetër të mbetur. Kjo sjell rrjedhimisht fuqizimin e një kategorie të caktuar, në nivel tepër të lart dhe në anën tjetër thellimin e skamjes së të vobektëve.

Por le të kthehemi edhe njëherë te pyetja,

1. Kilavuz, Sami, "Akaidi Islam dhe Hyrje në Kelam", Ensar Neshrijat, Stamboll, Tetor 2004, Botimi 10, fq 25.

2. Po aty.

3. Buhari, "Xhenaiz", 80; "Tefsiri i sures nr. 30".

4. "Akaidi Islam dhe Hyrje në Kelam", fq 26.

5. Lombard, Joseph, "Islami, fundamentalizmi dhe tradhëtimi i traditës", Logos-A, Shkup 2016, fq 454.

6. Ibn Khaldun, "Muqaddimah: An Introduction to History", tr. Franz Rosenthal, Princeton University Press, 1967, fq. 65-9.

për çfarë i duhet shoqërisë moderne feja?

Sociologët dhe specialistë të ndryshëm të shkencave shoqërore pohojnë lehtësisht se është një dukuri sa vjen e në rritje kthimi i vëmendjes së njerëzve nga feja. Kjo erdhi si shkak i zhvishjes së njeriut modern apo post-modern prej anës shpirtërore dhe fokusimit të tij me tërë qenien te ajo që është materiale. Zbrazëtinë shpirtërore të njeriut, pakënaqësitë e tij të brendshme dhe çfarëdolloj çrregullimi tjetër zgjidhjen mund t'ia jepte vetëm ajo që e kishte shkaktuar, mungesa e fesë, pra rikthimi edhe njëherë i saj në jetën shoqërore.

Në këtë periudhë njerëzit morën për sistem jetese ideologji, që siç thuhet lindin në rrethana të lëkundura dhe si të tilla vdesin. Këto qasje të reja siç mund të përmendim materializmin, racionalizmin dhe pozitivizmin hyjnizuan veten dhe materien, duke mos i dhënë të drejtë jete shpirtërore dhe metafizikes. Edhe pse me një dëm të konsiderueshëm lëkundën të vërtetat e fesë, nuk arritën dot që ta hidhnin poshtë atë.

Globalizmi në anën tjetër solli si pasojë rritjen e konsumit dhe pamjaftueshmërinë e burimeve. Në këtë periudhë industrializimi burimet natyrore u shfrytëzuan pa kriter dhe si përfundim njeriu modern nuk arriti të ngopej. Feja i sjell kufizime njeriut në aspektin e të jetuarit pa asnjë lloj kriteri dhe pa menduar për brezat në vazhdim dhe të ardhmen e ekosistemit të përbashkët. Ajri, uji që pimë janë më të rëndësishëm dhe të pazëvendësueshëm në krahasim me zhvillimet industriale kolosale.

Feja stimulon te njeriu një jetesë mesatare të rehatshme, të matur, por jo edhe të zhytur brenda materiales dhe detyrimisht të ekzekutuarin e shpirtërores. Prej pasojave më të mëdha që solli kjo epokë e zhvillimit marramendës teknologjik ishte edhe degradimi i familjes dhe dobësimi i rolit të saj në shoqëri. Familja lëngon nga thyerja që përjetoj në thelb të saj dhe dorën për ndihmë mund t'ia zgjasë vetëm feja, duke

bërë thirrje për rimëkëmbjen e saj dhe duke e konsideruar atë si të shenjtë, me një rol të pazëvendësueshëm.

Morali po përjeton ditë të vështira, ndërkohë që vlerat po zëvendësohen nga antivlerat dhe e reja apo e huaja shihet të jetë dominuese, pavarësisht dëmeve të saj. Modernizmi duke kërkuar t'ia japë më shumë të drejta gruas, siç shihet më shumë i mori sesa i dha asaj. I mori në emër të motos së barazisë dhe mundësive të barabarta. Duke harruar kështu se raporti burrë-grua është vetëm se raport ndërplotësues dhe secili bën më së miri atë që i përshtatet natyrës së tij⁷.

Psepranuamtëudhëhiqemidhedrejtohem nga ideologji të tilla, të pavërtetuara pozitive nga përvoja historike dhe braktisëm fenë, e cila vazhdon t'ia rezistojë kohërave dhe me parimet e saj ngre zërin shpeshherë se ajo ka bazë hyjnore dhe vlera universale, të cilat duhen ruajtur me ngulm. Njeriu në këtë kohë që jetojmë nuk duhet të silllet rreth kultit të individit, të ecë pa parime të ngulitura fort dhe të braktisë fenë, një sistem jete që ka shumë për t'ia dhënë shoqërisë.

Si përfundim mund të themi se feja është një institucion tepër i rëndësishëm i shoqërisë. Ajo i ofron njerëzve një sistem jetese të ekuilibruar dhe plotëson nevojat e tyre bazë. Këto nevoja mund të përkufizohen si shpirtërore, por dobia e tyre mund të shihet edhe në aspektin material. Feja e plotëson zbrazëtinën e shpirtit të njeriut duke e mbushur me besim dhe duke e kthyer kah Krijuesi i tij. Gjithashtu feja përmban një sistem të lartë morali, që rregullon në formën më të mirë marrëdhëniet ndër-njerëzore. Në saj të këtij morali dhe kësaj etike të lartë njeriu do të fitojë edhe njëherë ndjenjën e përgjegjësisë që ka ndaj vetes, Zotit dhe gjithësisë. Mbrojtja e njeriut, shoqërisë dhe ekosistemit është një nevojë alarmante rëndësishme e të cilave feja na e shpjegon në mënyrën më të mirë.

7. Lumbard, "Islami, fundamentalizmi dhe tradhëtimi i traditës", fq 447-51.



Mrekullia e namazit



Allahu i Madhëruar thotë: **"...dhe falni namazin"** (Bekare, 43)

"O ju që besuat, përluni dhe bini në sexhde, adhuroni Zotin tuaj, dhe bëni mirë, që të mund të shpëtoni!" (Haxh, 77)

Ajo që e dallon 'gjimnastikën' e namazit është shpërndarja e saj në mënyrë të organizuar gjatë 24 orëve, natën dhe ditën. **"Namazi (falja) është për besimtarët i detyruar në orë të caktuara."** (Kur'ani, 4/104)

Shkencëtarët kanë vërtetuar se, gjimnastika më e mirë është ajo e përditshme, e përsëritur dhe e shpërndarë në të gjitha orët e ditës, dhe jo rraskapitëse, siç mund ta kryejë çdo njeri. Të gjitha këto veçori gjenden te namazi.

Gjithashtu, sexhdeja ka ndikim pozitiv mbi enët e gjakut të trurit. Ulja e kokës poshtë çon në kongjestiv të gjakut nëpër enë dhe, kur koka ngrihet lart menjëherë, realizohet ulja e tensionit brenda enëve të gjakut.

Po kështu namazi shoqërohet me qetësi shpirtërore dhe kthjelltësi mendore. Ne përllemi në drejtim të Qabes, që është busulla shpirtërore e botës islame. Rajoni qendror i tokës përfshin Mekën, e cila është qendra e botës dhe pika ku, për myslimanët, boshti qiellor prek planin tokësor. Meka gjithashtu quhet "Nëna e qyteteve" (Umul Kura), në Kuranin e Shenjtë. Qabja tani, jo vetëm është vendosur në qendrën e Tokës, sipas "teorisë navale", por formon pikën qendrore të gjithësisë.

Dobinë e namazit, për shëndetin e njeriut, mund ta përmbledhim si më poshtë: vë në lëvizje të gjithë muskujt lidhës të trupit dhe të gjitha kyçet, madje edhe rruazat e shtyllës kurrizore, dhe kjo në çdo rekat.

Gjallëron zemrën dhe qarkullimin e gjakut. Përmirëson funksionimin e trurit, për shkak të përmirësimit të kapacitetit të prurjeve të gjakut në tru. Forcon muret dhe muskujt e trurit. E mëson trupin të përshtatet në situata të papritura. Siguron qetësi shpirtërore.

Glandi pineal në tru quhet "syri i tretë". Ai luan një rol të rëndësishëm në sensin e drejtimit.

Dëmtimet e glandit pineal shkaktojnë defekte në sensin e drejtimit, ndoshta meqë ndryshojnë ambientet elektromagnetike, intrakanjale e intrisikike, duke përfituar kështu defekte në mekanizmat e përgjigjes magnetike. Ekziston një përqendrim i madh i magnetit (oksidit të hekurit magnetik) te njeriu, në kockat dhe në bazën e kafkës. Kur e vendosim ballin në tokë, gjatë sexhdes, shumë herë në ditë, është e pamundur të mos mendojmë se, disa valë elektromagnetike, që vijnë nga Qabja, të arrijnë në glandin pineal, dhe ta ndihmojnë sensin tonë të drejtimit; siratulumstekim, shtegu dhe rruga e drejtë.

Muskujt në trupin e njeriut arrijnë në disa qindra. Fijet nervore janë të shumta, të përhapura, të ndërthurura e të grupuara si telat e korrentit.

Numri i kockave në trupin e njeriut arrin në 360. Për këtë arsye, namazi është gjimnastikë trupore e shkëlqyer, gjatë së cilës lëvizin kyçet, kockat dhe muskujt, si dhe gjallërohet qarkullimi i gjakut.

Mendo, 5 namaze (5 seanca gjimnastikore) çdo ditë, që shtohen e përsëriten sa më shumë rritet besimi i njeriut.

Ushtrimet e pamundimshme ndikojnë në mirëqenien emocionale dhe rrisin jetëgjatësinë. Ushtrimet e rregullta fizike, gjithashtu, rrisin mundësinë që personi të mbetet aktiv me kalimin e moshës edhe në pleqëri. Ushtrimet përmirësojnë forcën fizike dhe stabilitetin e nyjeve.

Ato përmirësojnë lubrifikimin dhe diapazonin e lëvizjeve, si dhe përmbytjen e fleksibilitetit. Përforcimi i muskulit kryesor në lëvizje aktive të kyçit, siç bëhet në faljen e namazit, parandalon trombozën e thellë të venave, e cila shkakton kalcifikimin e gjymtyrëve tek të moshuarit. Ushtrimet

parandalojnë sëmundjet koronare të zemrës, përmirësojnë karbohidratet dhe ndihmojnë diabetikët.

Personat që bëjnë ushtrime të rregullta, siç është falja e namazit, nuk rrudhosen kur plaken.

Dobitë psikologjike të namazit

Ushtrimet përmirësojnë mënyrën e mendimit dhe të sjelljes, cilësinë e jetës, reduktojnë shqetësimet dhe depresionet nervore. Influencojnë në mënyrë të favorshme dhe kontribuojnë në vetëvlerësimin dhe në vetëbesimin e njeriut. Përsëritja e vazhdueshme e ajeteve të Kuranit të Shenjtë, do ta ndihmonte njeriun të ekranizonte mendjen dhe do të lehtësonte përpunimin e mendimeve që hyjnë në tru.

Përsëritja e lutjeve gjallëron aktivitetin muskolor të çftuar në mosnjohjen pasive të mendimeve

intruzive; shkakton gjithashtu uljen e BP-së dhe uljen e konsumit të O₂, me një punë më rezultative të zemrës dhe të organeve të frymëmarrjes.

Islami është e vetmja fe, ku lëvizjet fizike të lutjeve janë të kombinuara me ushtrimet shpirtërore.

Ritualet islame janë unike për tensionet e çliruara në muskujt gjatë lëvizjeve fizike, ndërsa, në të njëjtën kohë, përbërësit shpirtërorë të tyre bëjnë të mundur çlirimin e tensionit mendor.

Dobitë sociologjike të namazit

Namazi është bartës dhe burim i fuqisë, mprehës i vullnetit, ushqim shpirtëror, që e frymëzon njeriun për të fituar betejën e jetës.

Namazi është burimi dhe fuqia më e madhe për lindjen e shkathtësisë së njeriut, ashtu si radiumi që

është burimi i rrezeve radioaktive e njëherësh është një nga barnat që të pastrojnë nga sëmundjet e ndryshme.

Namazi është lidhja e drejtpërdrejtë me Fuqinë Absolute prej së cilës kërkojmë ndihmë, që t'i përballojmë sa më lehtë problemet jetësore dhe me një optimizëm të thellë.

Namazi është si mali më i lartë, që rrënjët i ka të thella, ndikimi i të cilit është i rëndësishëm, me pasuri të shumëllojshme dhe nuk është enë e zbratur nga mineralet e jetës.

Namazi është fuqi prej së cilës buron adhurimi, pastërtia, edukata dhe morali.

Këshilla 2



47. Sa i bukur që është ai lot, i cili pikon nga syri që qau nga frika e Allahut!
48. Dyert e hallallit janë të shumta, pse atëherë ia ngushton vetes jetën dhe troket në derën e haramit?!
49. Vdekja reale është ajo, kur ndalet zemra jote nga ndjenja e të bërit mëkat!
50. Nuk përkujdesem për atë që është me mua në fillim, po përkujdesem për atë që është me mua gjithmonë, deri në fund, në fillim të gjithë janë të mrekullueshëm!
51. Humbje e vërtetë është ta jetosh jetën tënde pa namaz!
52. Ajo që është e jotja, do të vijë pavarësisht dobësisë sate dhe ajo që nuk është e jotja, nuk do ta arrish as me fuqinë tënde.
53. Mirë është të jesh si deti, pamja jote e jashtme të jetë e qetë dhe e hijshme, kurse brendësia jote botë e thellë!
54. Dita më e mirë është ajo ditë që në të nuk i bën gjynah Allahut!
55. Mos e bëj mirësinë tënde libër që e shfletojnë të gjithë, ka njerëz që nuk meritojnë ta lexojnë asnjë shkronjë nga ai!
56. Prej gabimit është që t'i rregullosh gjërat përreth dhe ta lësh kaosin në zemrën e tënde!
57. Morali i mirë është dritë, e cila ta ndriçon çdo rrugë!
58. Kur jep sadaka, ti nuk i humb të hollat, po ato ia dërgon vetvetes në një periudhë tjetër!
59. Gjëja e vetme, e cila e meriton pikëllimin tim, është mangësia ime ndaj Zotit tim!
60. Të suksesshmit i realizojnë synimet e tyre, kurse dështakët krijojnë arsye time për dështimet e tyre!
61. Është për të të ardhur shumë keq, se gjokset tona janë të mbushura me shumë gjëra, të cilat nuk na përkasin neve!
62. Gjumi duke dëgjuar Kuran, të bën të zgjohesh në rehati, e cila nuk ka fund!
63. As varfëria s'mund t'i mposhtë shpirtrat e fortë, e as pasuria s'mund t'i ngritë shpirtrat e poshtër!
64. Nga gjërat më të këqija që mund të ndodhin në jetë është të posedosh në zemrën tënde fjalë që gjuha nuk mundet t'i përkthejë!
65. Sabri është si ilaç i hidhur, mirëpo rezultatet e tij janë të mira!
66. Nuk interesohet për ty, përveç atij që e vëren se dita e tij është e mangët pa ty!
67. Në fund të lojës së shahut, edhe mbreti edhe ushtari, shkojnë në të njëjtën kuti!
68. Fal, se edhe ti po ashtu ke gabuar një ditë nga ditët!
69. Nëse do të mësosh diçka nga begatitë e

Allahut, vendosi duart e tua mbi sytë e tu!
70. Bëhu në jetën e tjerëve si kokrrat e sheqerit, saqë edhe nëse largohesh, pas teje e lë shijen e ëmbël!
71. Digji gjynahet e tua me istigfar, në të kundërtën do të vijë dita kur ato do të të djegin ty!
72. Mos ndiej keqardhje nëse të iku posti apo pozita, por ndiej keqardhje, nëse të iku namazi!
73. I arsimuar bosh është ai i cili lexon nëpër shkenca të ndryshme, kurse në qoshtet e librarisë e ka Kuranin, të cilin nuk e ka prekur asnjëherë!
74. Lehtë është të gjesh njeri me të cilin do të flasësh, por rëndë është të gjesh njeri që i beson!
75. Nganjëherë fiton, e nganjëherë mëson!
76. Kërkimfalja është kulturë e lartë, injorantët besojnë se ajo është nënçmim për shpirtin!
77. E meta për ne është bërë më e rëndë sesa harami, sepse ne jemi shoqëri e cila frikohet më shumë nga krijesat sesa nga Krijuesi!
78. Asgjë nuk kthehet më si më parë, mësoje mirë këtë shprehje, para se të thyesh diçka të bukur!
79. Përvojat nuk lexohen nëpër libra, mirëpo librat ndihmojnë të përfitohet nga përvojat!
80. Njerëzit i ndryshojnë fytyrat e tyre për çdo ditë, për këtë arsye mos e kërko vlerën tënde në fytyrat e njerëzve!
81. Po flemë e po zgjohemi dhe celularët nëpër duart tona, mendjet ikën dhe u humbën, as Kuran, as Sunet, e madje as dhikër! O Zot, bëhu i butë me gjendjen tonë dhe kthena kah Ti me kthim të mirë!
82. Besnikëria është si kalaja nga rëra, e rëndë të ndërtohet, kurse shumë e lehtë të shkatërrohet!
83. Bëhu ai person që kur e shohin njerëzit thonë se në dynja ende ka hair!
84. Alij ibën Ebi Talib, Allahu qoftë i kënaqur prej tij, tha: "Nuk u thanë lotët, vetëm se nga ngurtësia e zemrave dhe nuk u ngurtësuan zemrat, vetëm se nga gjynahet e tepërta."
85. Ia vodhën hajdutët shtëpinë, qau një muaj, ia vodhi shejtani zemrën, as që e hetoi!
86. Zgjidhi banorët e zemrës sate me precizitet, ngase qytetet njihen sipas banorëve të saj!
87. Nganjëherë guri është më i butë, sesa zemrat e disa njerëzve!
88. Ruaje çdokënd që pyet për ty dhe për gjendjen tënde, ata janë të rrallë në këtë kohë!
89. Familja ime kaloi gjatë duke më mësuar se si të flas dhe unë tash kaloj kohë edhe më të gjatë të mësohem se si të heshti!
90. Bëj mirë, ngase ajo është e vetmja gjë që nuk vdes kur ti mungon!
91. Nëse ke mundësi që ta sundosh zemërimin tënd për një moment, do t'i kursesh vetes një mijë ditë nga pendimi!

92. Shoku më i mirë në jetë është qetësia, kjo, sepse ajo t'i mëson gabimet e tua, atëherë kur vetmohesh me të!

93. Mos i qorto shumë të tjerët! Ai i cili të do, e ka mundësinë të krijojë një mijë tregime që të flasë me ty, kurse ai i cili nuk të do, e ka mundësinë të krijojë një mijë arsytetime që të largohet nga ti!

94. Mos u dëshpëro asnjëherë! Ai që e krijon të gjallën prej së vdekurës dhe krijon të vdekurën prej së gjallës, ka fuqi që shpresat e tua t'i nxjerrë nga ëndrra në realitet!

95. Nuk mund ta përfitosh një zemër me fuqi, por mundesh me një fjalë t'i përfitosh zemrat e njerëzve!

96. Jetojmë me një kohë, ku nëse i thuhet gurit bëhu njeri, do të thotë: Ndjesë, nuk jam aq i ngurtë sa duhet!

97. Kur do të posedosh një gjë që nuk e ke pasur më herët, detyrohesh të veprosht një gjë që nuk e ke bërë më herët!

98. Frikohem të ndahem nga jeta se mos në zemrat e të tjerëve shkaktova ndonjë plagë me duart e mia! O Zoti im, mos i bëj fjalët dhe sjelljet e mia shkak për vuajtjen e askujt!

99. Disa njerëz janë si vatani, ndarja prej tyre është kurbeti më i rëndë!

100. Disa njerëz janë si historia, as nuk kthehen, e as që harrohen!

101. Të suksesshmit i realizojnë synimet e tyre, kurse dështakët krijojnë arsytetime për dështimet e tyre!

102. Mos ia ki zili tjetrit për atë që ai e posedon, ti ke më shumë, mirëpo nuk e di!

103. Gjatë kohës kur je i lumtur, falënderoje Allahun.

104. Gjatë kohës kur je i qetë, përmende Allahun.

105. Dy gjëra e ndryshojnë pikëpamjen tënde rreth jetës: Sëmundja dhe vetmia!

106. Jeta nuk është ato ditë që kaluan, po ato ditë që i rikujton!

107. S'ka dyshim në lutje: Ose do të të përgjigjet, ose do të jetë sebeb që ta largojë një të keqe, ose

do të ruhet për në ahiret!

108. Nëse do që të mos ndiesh keqardhje për ndonjë gjë, veproje çdo gjë për hir të Allahut!

109. Në jetën tënde, çdo ditë jetoje si të jetë dita e fundit, se një ditë nga ditët, me të vërtetë do të jetë ashtu!

110. Para se t'i ngritësh sytë dhe të kërkosh nga Allahu atë që të mungon, zbriti sytë dhe falënderoje Allahun për atë që e posedon!

111. Lëre të kaluarën të ecën dhe fjalët e njerëzve të kalojnë, a ke dëgjuar për ndonjë njeri që e fitoi garën duke u kthyer mbrapa?!

112. Periudhat e udhëtimit janë të gjata dhe të lodhshme për atë që nuk ka shoqërues në udhëtimin e tij, kështu është edhe rrugëtimi i jetës!

113. Kulmi i sabrit është të heshtësh, por në zemrën tënde ke plagë që flet dhe kulmi i fuqisë është të buzëqeshësh, por në syrin tënd i ke një mijë lot!

114. Luani qëllimisht bëhet sikurse ndien dhembje kur e kafshon i vogli i tij, që ta bëjë të ndiejë se ai posedon fuqi!

115. Para se të flesh, faljua njerëzve, ti nuk e di se, a ti do të ndahesh nga ata apo ata nga ti!

116. Mos e lër namazin asnjëherë, ka me miliona që janë nën varre, dhe shpresojnë që nëse kthehen në dynja të bien në sexhde, edhe po të ishte ajo vetëm një herë!

117. Ka mundësi të shohësh se shoku të shan, armiku të shpëton, pasanikët të kërkojnë rryshfet dhe të dobëtit të japin lëmoshë! Kjo është dynjaja!

118. Gjatë momentit kur je nervoz, ki mendim të mirë për Allahun.

119. Njerëzit mendojnë se ndjenja e lumturisë vjen si rezultat i suksesit, mirëpo në fakt është e kundërta, sukcesi është rezultat i ndjenjave të lumtura!

120. Gjysma e vuajtjeve të njerëzve vjen nga përpjekja e tyre ta paraqesin atë që nuk janë!

121. Të menduarit e tepërt për të ardhmen është vrasësi i parë i lumturisë sate.

122. Mos të të pikëllojë fakti se dështove me një projekt, përderisa mundohesh të qëndrosh përsëri në këmbët e tua!

123. Kur je në gjendje të keqe mos lexo diçka të dhembshme, ngase çdo herë kur i kalon faqet dhe lexon diçka, mendon se është shkruar për ty!

124. U pyet një i urtë:

– Çfarë është urtësia?

U përgjigj:

– Ta dallos atë që e njeh nga ajo që nuk e njeh!

151. Ai që të do respektoje, ai që ka nevojë për ty ndihmoje, ai që të lëndoi falja dhe ai që të braktisi, harroje!

152. Prej gjërave që më së shumti jep dhembje – shtëpia pa baba.

153. Keqardhja nuk është mangësi, por argument i prerë se ti je person që ke ndërgjegje!

154. Vendos pak nga ndjenjat në mendjen tënde që ajo pak të zbutet dhe vendos diçka nga mendja në zemrën tënde që ajo të përqendrohet!

155. Pak nga injorimi e kthen çdo person në madhësinë e tij të natyrshme.

156. Gjysma e botës e jetojnë jetën, kurse gjysma tjetër jeton për t'i mbikëqyrur!

157. Nganjëherë një situatë e thjeshtë në jetën tënde, të bën të ndalesh me veten një kohë më të gjatë dhe nga fillimi ta ndryshosh renditjen e njerëzve në jetë!

158. Mos mendo se qetësia që e sheh në fytyra aludon në kënaqësi, çdo njeri në brendësinë e tij ka diçka që e ngacmon dhe i jep dhembje!

159. Biografia e mirë është si druri i ullirit, rritet ngadalë, mirëpo jeton shumë gjatë!

160. Ajo që e bën pemën të ndiejë dhembje nuk është prerja e saj, po sēpata është ajo që i jep më shumë dhembje, sepse gjysma e sēpatës është nga vetë pema!

161. Nëse nuk je shi që ujit, mos u bëj zjarr që përvëlon!

162. Gjynahet i mbyllin dyert e njohjes dhe diturisë!

163. Prej gjërave që më së shumti dhemb është

atëherë kur i ankoresh të vdekurve se çfarë vepruan me ty të gjallët!

164. Heshtja ka mjeshtëri, prandaj nëse je mjeshtër në heshtjen tënde, do të bëhesh i mrekullueshëm në të folurit tënd!

165. Prej momenteve më të bukura të lumturisë është kur i realizon gjërat, që njerëzit për to mendojnë se ti nuk mund t'i realizosh!

166. Mos i jep të varfrit lēmoshë duke e ndier në vete se ai ka nevojë për lēmoshën tënde, por jepja atij dhe ti e di se ke nevojë për falje dhe praninë të saj nga Allahu!

167. Bëhu njeri i organizuar dhe personaliteti yt do të bëhet i dalluar!

168. Zogjtë që lindin në kafaz, besojnë se fluturimi është krim!

169. Edhe përsëri faktit që besoj se zgjidhjet e trurit janë më të qëlluara, vetëm se e kam shumë vështirë t'i braktisi disa gjëra që i zgjedh zemra!

170. Mos ngurro në mbylljen e syve nga pikëllimi, se ndoshta të kalon para teje lumturia dhe ti ec e nuk e vëren atë!

171. Mos u jep njerëzve më tepër sesa e meritojnë, se edhe lulet nganjëherë prishen nga uji i tepërt!

172. Më të rëndën që e bën njeriu është të marrë një vendim të rëndësishëm, vetëm e vetëm që t'i kënaqë të tjerët!

173. Zgjedh nga kujtimet e tua atë që të përshtatet!

174. Zot, mos më largo nga tri gjëra: Nga namazi im, nga kënaqësia e prindërve dhe nga ata që i dual!

175. Zot, bëje çdo gjë që e shpresoj të jetë afër syrit tim si afërsia e zemrës sime me shpirtin, dhe o Zot, bëje që çdo gjë që ia kam frikën të jetë larg syrit tim, si largësia e qiejve me tokën!

176. O Zot! Mos e bëj që dynjaja të jetë preokupimi ynë më i madh!

177. O Zot, na jep siguri nëpër vendbanimet tona dhe na i përmirëso me Kuran shpirtit tanë!

178. Zoti im, prej Teje e kërkoj Xhenetin dhe prej Teje kërkoj mbrojtje nga zjarri i Xhehenemit!

Zgjohu



Po shih me qafë përkulur kush po qan?
E drejta për të jetuar, e jotja, o musliman!
Shpëtoje atë të pashpresë për hirë të Zotit,
Nga gjumërat e vdekjes zgjohu, pra!

Nuk u ngope, megjithë se ke kohë që fle,
S'të mbeti pa hequr, s' vure mend ende;
Ta shkelen vendin krye fund,
Kurse ti një herë vendit s'u trazove!

Tronditja që ndjeve, s' është ninanana,
Është një rrymë e përjetshme që rrjedh pa prâ;
Eja, bashkohu edhe ti me atë rrymë plot vrull
Që s' ndalon; emrin "kohë" e ka!

Rrymë zemërplasur: para si dilet dot;
Në pastë që t'i dalë, bëhet copë-copë!
Pse vrapon pas dallgëve që s'e di nga shkojnë,
Ç'është ky pasion për të rënë në gropë?

Tmerrin e së kaluarës sille në kujtim;
Askush s'të vrapon nesër në ndihmë!
Nëse ti s'ke mëshirë për veten,
A s'ke mëshirë as për birin tënd?

PO ngrihesh të bësh një veprim pa kuptim
Duke thënë: "Une e kam sjellë në botë birin tim...?"
E drejta prindërore, për fat të keq,
I shtyka njerëzit edhe në këtë krim!

A është e drejtë të biesh në pashpresim?
A s'ka ndonjë zgjim me zell e durim?
Mos është mengjes kiameti ç'po pret?
Dita po përendon, ti kërkon zgjim!

Jeta e popullit që i mban syt pas,
Bëhet vrapim drejtë fatkeqësisë.
Zoti të ardhmen ta ka vënë para
Ta shohësh, kurse ti ende s'ke ndërmend!

O Lindje e madhe, o i pafund meskinitet!
Mendo edhe ti të shkundesh, mos rri në vend!
Kam frikë se nesër nga dora e Perendimit,
E keqe pa hequr S'ka për të mbetë!

Po qe trim, duhet ta rrëmbesh me gjak
Të drejtën për të jetuar pa tu shkelur prapë;
Sepse sot, i zoti i të drejtës së vet
Është ai që thotë: "Të drejtën s'e jap!

“

**ATA DUAN TA SHUAJNË DRITËN E ALLAHUT ME GOJËT
E TYRE, PO ALLAHU DO TA PLOTËSOJË DRITËN E TIJ,
EDHE PSE KËTË GJË E URREJNË JOBESIMTARËT.**

KURAN, SURJA SAF, 61:8.

